**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË**

# P L A N I DH E P R O G R A M I

# I PUNËS EDUKATIVE ME NXËNËS TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT SPECIAL

**Prishtinë**
**2007**

**Këshilli redaktues**:

Dr. Fehmi Ismaili, kryeredaktor

Mr. Miranda Kasneci

Ramush Lekaj

Luljeta Kabashi

## UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE TË PROGRAMIT

### Hyrje

Detyrat dhe përmbajtja e programit të punës edukative në konvikte shkollore me nxënës me nevoja të veçanta rrjedh nga Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm 2002/2 të Kosovës.

Programi i hartuar i punës edukative në konvikte shkollore për nxënës me nevoja të veçanta përfaqëson një program të punës edukative që çdo Shkollë Speciale ose Qendër Burimore që mund t'a zbatoj në kufijtë dhe mundësitë e kushteve objektive.

Përmbajtja programore e punës edukative në konvikte shkollore për nxënës me nevoja të veçanta ka karakter projektues dhe orijentues. Ato përmbajnë intencë të përgjithshme të synimit dhe të detyrave si dhe të përmbajtjeve edukative të cilat duhet të realizohen në punë, duke u bazuar në specifikat relevante sipas moshaës së nxënësve dhe të kushteve të punës dhe jetës në konvikte shkollore.

Përmbajtjet programore rrjedhin nga: a) nevojat e përgjithëshme të punës në edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në përgjithësi, b) nevojat për riedukimin të atyre fëmijëve nëse kanë çrregulimet në sjellje e që janë lajmëruar si shkak i kushteve sociale apo kushteve tjera jetësore në të cilat nxënësi i ka pasur para se të vijë në shkollë dhe konvikt. c) nevoja e largimit të konsekuencave që te fëmija ka lënë shurdhësia apo shkalla e dëmtimit të shqisës së dëgjimit apo shkalla e dëmtimit të shqisës së të pamurit, dhe me qëllim të ndërtimit të personalitetit në mënyrë që të jetë i gatshëm të hyjë në mjedisin shoqëror dhe social.

Ky program do të shërbejë stafit pedagogjiko-edukativ që sa më mirë të organizojnë punën edukative në konvikte shkollore, gjithashtu shërben si projekt i punës dhe ka karakter orientues për konkretizimin e veprimeve edukative në konvikte shkollore.

### Parimet e përgjithëshme të organizimit të punës në konvikte shkollore

1). Kolektivin themelor të konviktit, bashkësinë e nxënësve e përbëjnë nxënësit, dhe ndahen në grupe edukative, të cilat i përfshijnë kategoritë të nxënësve:
- Grupin edukativ të parashkollorëve ( niveli 0) deri në 8 nxënës
- Grupin edukativ të shkollës fillore dhe të mesme të ulët ( nivelit 1 dhe 2) deri në 10 nxënës
- Grupin edukativ për fëmijët me nevoja të veçanta të kombinuara deri në 8 nxënës
- Grupin edukativ i nxënësve të shkollës së mesme të lartë ( niveli 3 ) ose të arsimit professional deri në 15 nxënës

Në kuadër të konviktit shkollor punojnë edhe grupe të veçanta – seksione dhe grupe të interesit ( sportive, natyrore, punë dore, artit, grupe interesi të teknikëve të rinjë, modelistëve etj. ), dhe organizohen sipas specifikave të punës së konviktit

2). Çdo konvikt shkollor, i mbështetur në UA është i detyruar të bëjë skemën e kuadrit edukativ dhe stafit mbështetës dhe të kujdeset për zhvillimin profesional të tyre.

3). Këshillin pedagogjik e përbëjnë edukatorët, drejtori, personeli medicinal, kujdestari/ja, dhe sipas nevojës edhe bashkëpunëtorët profesional.

4). Struktura orijentuese e orarit të punës të edukatorit në skemën 30 orëshe është:
- 12 orë përgatitje e nxënësve për mësim
- 6 orë punë edukative sipas përmbajtjeve të komponenteve edukative
- 3 orë punë në seksione, grupet e interesit, puna plenare dhe individuale me grupe edukative për zgjidhjen e problemeve edukative.

- 3 orë përgatitje për punë edukative
- 6 orë në punë profesionale, bashkëpunimi me mjedisin shoqëror, me ndonjë shkollë tjetër, punëtori etj.

## Qëllimet

Qëllimi i përgjithëshëm edukativ në konvikt është që tek fëmijët dhe të rinjët me nevoja të veçanta të formojmë një personalitet të gjithanshëm, krijues, me vështrim të lirë në botën që na rrethon, në natyrën dhe shoqërinë.
Personaliteti i të edukuarit përfshinë në veti edhe shëndetin fizikë, formimi i vëshrtrimit moral dhe motivi për mësim permanent.

Qëllim i veçant i edukimit në konvikte shkollore për fëmijët dhe të rinjët me nevoja të veçanta është: të punoj në zbutjen e pasojave që mund të sjell shqisa e të dëgjuarit në zhvillimin fizikë apo psiqikë, zbutja e pasojave pamore ose intelektuale; të punoj në zhvillimin e të folurit dhe të komunikimit e tjera; i mundëson nxënësve të zotërojnë me sukses përmbajtjet mësimore dhe detyrat që i parashtron shkolla; ndërton marëdhënie të drejta interpersonale dhe i mëson ata me jetën në bashkësi dhe me këtë i përgatit për jetë normale kur të largohet nga konvikti shkollor.

## Përmbajtja dhe korniza e punës edukativo arsimore

Puna edukative është formë specifike e punës pedagogjike e cila ka për detyrë që te fëmijët me nevoja të veçanta që janë në konvikte shkollore të krijoj shprehi pozitive për jetë.
Përmbajtjet e punës edukative nuk mund të jenë universale, por duhet të përshtaten sipas moshës së nxënësve. Për këtë përmbajtje kornizë e punës edukative është e ndar në katër grupmosha: e I - parashkollorët, e II -arsimi fillor, e III - arsimi i mesëm i ultë dhe e IV- arsimi i mesëm i lartë.

Përmbajtjet edukative të grupeve edukative janë dhënë sipas komponenteve të punës edukative, të dimenzionuar sipas nevojave dhe mundësive psikofizike të nxënësit në përgjithësi, në mënyrë që si projektim dhe orijentim çdo grup edukativ të detajizoj nevojat e veta specifike.

## Burimet dhe mjetet mësimore:

Është kompetencë e edukatorit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon, shkolla të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore edukative, duke i kushtuar vëmendje barazpeshës së të dhënave gojore, vizuale, auditive dhe audiovizuale, me anë të gjuhës së shenjave, bilingualizmit, metodave alternative të komunikimit etj. me theks të veçantë në atë që është qenësore për t’u mësuar.
Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t’i takojë edhe nxënësit.

## Programimi i punës edukative në konvikt

Çdo konvikt shkollor fushëveprimin edukativ e vërteton sipas këtij programi të punës edukative me programin kornizë vjetor të punës edukative i cili bazohet në përvojat e viteve të mëparshme në programin perspektiv të zhvillimit të konviktit dhe shkollës, dhe në bazë të parimeve dhe detyrave të këtij programi.

Në bazë të programit vjetor, edukatorët së bashku me drejtorin dhe zv.drejtorin e shkollës i përpilojnë planet e punës mujore operative për grupe konkrete, sipas të gjitha specifikave. Këto plane operative pastaj i përpunojnë dhe i përpilojnë çdo grup veç e veç në plane javore edukative sipas grupeve të interesit.

Programimi i punës përpilohet për secilin grup në tërësi, programimi i punës në grupe të vogla dhe plane individuale të edukimit.

Programi i punës edukative realizohet me planifikim ditor dhe përpilimit të përgatitjeve për çdo ditë pune, ndërsa realizimi i këtij plani shënohet në ditar të punës edukative të grupit të cilin e udhëheq çdo edukator për grupin e vet edukativ.

Parimet e programimit, organizimi i grupeve edukative dhe normativet e punës edukative ( përgatitja profesionale e edukatorëve, medhësia e grupit edukativ, ritmi ditor, regjimi ditor etj.) në konvikte dhe shkolla me fëmijë me nevoja të veçanta kryesisht janë identike me punën edukative me konvikte të rregullta, sipas dispozitave të ligjit dhe akteve tjera normative.

## Edukimi parashkollor

Edukatorja/i në konviktin e fëmijëve, duhet të ketë parsysh momentin se çfarë pozite duhet të zë në radhë të parë në punën edukative, më shumë të marrë pozitën e prindit, apo më shumë pozitë specifike profesionale, të zë pozitë qendrore apo më shumë pozitë të dorës së dytë, në mënyrë që të bëjë të mundur pavarësinë e fëmijëve. Secili edukator duhet të bëjë përpjekje që fëmijëve t'u ofrojë sa më shumë përvoja dhe vlera, që janë të lidhura me jetën e familjes dhe të cilat përjetohen në familje, por vlera edukative e konviktit dhe drejtimi i veprimit të tij edukativ nuk shterrojnë vetëm me imitimin dhe me kompensimin e edukimit familjar.

Është shumë i rëndësishëm edhe raporti i konviktit ndaj shkollës. Edhe pse në radhë të parë fëmija arsimohet në shkollë në nivele të ndryshme, edukimi konviktor nuk do t'u përgjigjej detyrave të veta, po të mos orientohej që të siguronte kushte që konviktori si fëmijë të mund të përmbushë maksimalisht detyrat dhe kërkesat e shkollës. Prandaj, veprimtaria pedagogjike në konvikt duhet të jetë e lidhur shumë ngusht me shkollën. Për këtë qëllim në programin e vet të edukimit, konvikti duhet të ngërthejë doemos edhe çështjet e të nxënit, të ndihmës në të nxënë, të kryerjes së detyrave të shtëpisë, të mungesave në shkollë, të punës plotësuese me nxënës të cilët kanë vështirësi në nxënie, të bashkërendimit të punës me shkollën lidhur me organizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare dhe të kohës së lirë të fëmijëve. Krahas familjes dhe shkollës, është e nevojshme që konvikti të vërë lidhje të ngushta edhe me të gjitha institucionet e tjera, me shërbime dhe me organizata shoqërore e profesionale, të cilat janë të interesuara për edukimin e fëmijëve, p.sh. me këshillimore për probleme të edukimit të fëmijëve, me institucione të aktiviteteve jashtëshkollore, me qendra për punë sociale, me institucione mjekësore, me organizata të përgjithshme e të specializuara të fëmijëve etj.

**Edukimi parafillor**

**Aktiviteti: Zhvillimi i të folurit dhe i gjuhës** **( 74 orë në vit )**

**Udhëzime:** Të gjitha temat gjuhësore duhet të shërbejnë si shtytës për njohurit e reja për fëmijët dhe të kërkoj informacione të tjera nga të rriturit. Përpjekjet duhet të jenë që fëmijët me nevoja të veçanta të nxëjnë, gjithashtu të zhvillojnë të folurit dhe gjuhën.

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| **Zhvillimi i të folurit** | - Konstatimi i gjendjes në të folurit e fëmijëve dhe përmirësimi i të folurit egzistues<br>- Kategoritë gramatikore dhe format e tyre nëpërmjet përdorimit të të folurit në jetën e përditëshme dhe në mesin ku jeton (dhoma, të ngrënit, veshja, lojrat e ndryshme dhe loja në përgjithësi etj.)<br>- Ndërtimin e të folurit dhe gjuhës së fëmijës:<br>- Emrat e gjësendeve të ndërlidhura me zgjimin nga gjumi, për larjen, për veshjen, shkuarja në gjumë etj.<br>- Komunikimi lidhur me marrjen e ushqimit,<br>- Komunikimi dhe çdo gjë që vie si produkt i lojës ( disponimin, antidisponimin, arritja e suksesit etj.)<br>- Komunikimet me fëmijët dhe me të rriturit.<br>- Vështirësitë e të folurit dhe gjuhës të cilët ndikojnë në zhvillimin e fëmijës,<br>- Komunikimet lidhur me disa shtazët shtëpiake dhe bimët të afërta për fëmijët dhe të gjithë ato të cilat i ineresojnë atyre nga mjedisi që e rrethon. | Adaptimi i fëmijëve me jetën kolektive, ndieshmëria për komunikim përmes të folurit, gjuhës së shenjave, bilingualizmit, mimikës dhe perceprimit vizuel, komunikimi alternativ etj.<br><br>Fëmijët dinë të emërtojnë gjësendet nga shitorja, komunikimi me shokët e grupit dhe me të moshuarit<br>Kuptojnë prezentimet gojore<br>Dëgjon tinguj dhe fjalë të ndryshme |
| **Të folurit në funksion gjuhësor** | - Zhvillimi procesit të të folurit dhe mundësia e të lexuarit nga goja<br>- Njohja me figurën e fjalës pa vështruar çdo shkronjë veç e veç.<br>- Ushtrime të leximit nga goja me fjali të shkurta, fjalë, rrokje, tinguj, shkronjë, tekste të shkurta etj.<br><br>- Të folurit aktiv në grup, prezentimet gojore dhe rregullat e komunikimit<br><br>- Pasurimi i të folurit me fjalë dhe me shprehje të reja<br>- Pasurimi dhe zgjërimi i të folurit joverbal përmes gjuhës së trupit<br>- Leximi i ilustrimeve, fotografive, figurave, vizatimeve dhe objekteve të ndryshme | Fëmijët shqiptojnë në mënyrë të drejtë rrokjet, tingujt dhe shkronjat<br>Kuptojnë të folurit në grup duke respektuar rrezulltatet gjatë komunikimit<br>Shqiptojnë drejtë tingujt, fjalët, fjalitë e thjeshta duke pasur kujdesë intonacionin e tyre<br>Përvetësojnë ndjenjat joverbale përmes gjuhës së shenjave, bilingualizmit, mimikës perceptimit vizual.<br>Lexon përmes shenjave dhe mbishkrimeve me ndalesa , vërejtje , urdhëresa etj |

| | | |
|---|---|---|
| **Te folurit në funkson të zgjërimit të leksikut** | -Aktiviteti:”Kalendari im” Në kalendarin tim pasqyrohen ditët e javës,<br>-Aktiviteti: Lidhja e objekteve me emërtimet dhe funksionet e tyre ( termometër, çekan , llamp)<br><br>-Aktiviteti: Ndërveprimi, bashkëpunimi i fëmijëve me njëri- tjetrin në grup dhe manipulimi me materialet në zhvillimin e aftësive në shkrim-lexim.<br><br>Lojë dramatike: Përmes lojës fëmijët komunikojnë me njëri- tjetrin, shprehin mendimin e tyre, dhe arrijnë të bashkëpunojnë e të zgjidhin probleme të ndryshme. | Fëmijët dinë të plotësojnë me etiketa për ditën, motin dhe datën, duke i ndryshuar etiketat që paraqesin motin, ditën dhe datën. Fëmijët dinë të bejnë lidhjen e objektit me emërtimin dhe funksionin e tij.<br><br>Fëmijët dinë të bashkëpunojnë me anëtarët e grupit të vogël.<br><br>Fëmijët diskutojnë dhe bashkëpunojnë me grupin dhe përmes grupit afirmohen në aspektin e individulaitetit të tyre. |
| **Të folurit** | -Aktivitetet e të folurit, gjuhës së shenjave (mimikës dhe gjestikulacioneve), prezentojnë mesazh, kundërshtim, dëshirë etj..<br><br>-Të folurit aktiv me fëmijët, pasurimi i fjalorit e tyre me fjalë- mimikë (gjuhë e shenjave) dhe shprehje të cilat lidhen me përditshmërinë në fushat e ndryshme të jetës.<br><br>-Aktivitete: ritregim i përrallëzave, përrallave, gjëegjëzave, tregimeve të shkurtëra, pjesë dramatike etj. | Arrijnë marrëveshje dhe kuptohen në grup duke respektuar rregullat e sjelljes dhe komunikimit.<br><br>Përmes imitimeve dhe tregimeve të fëmijëve, ata janë në gjendje të luajnë role nga tregimet e zgjedhura nga fëmijët.<br><br>Nxënësit përvetësojnë ndjenjat joverbale përmes gjuhës së shenjave- mimikës dhe vëzhgimit të tyre. |

**Aktiviteti: Socializimi i fëmijës** **( 35 orë në vitë )**
**Objektivat:**

- Fëmijët të shpjegojnë dhe të gjykojnë për kërkesat e tyre dhe të identifikojnë dhe zgjërojnë detyrat e punës .
- Fëmijët të planifikojnë dhe realizojnë sjelljet për situata të ndryshme në shoqëri: në krahasim me shokët e tyre, me prindër dhe me të moshuarit (me të vjetrit).
- Të përshkruajnë ndjenjat e të bukurës në natyrë, për atë se çka njeriu mund të krijoj, si dhe të përshkruajnë dhe ndryshojnë rregullat në natyrë.

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATETE PRITSHME |
|---|---|---|
| **Përshtatja në jetën grupore** | - Pjesëmarrja në grupe të përbashkëta,<br>- Identifikimi i veçorive personale dhe të tjerëve<br>- Ndihma reciproke: veshja, kryerja e detyrave edukative etj<br>- Adaptimi (përshtatja) e fëmijëve në vendin e vetë në kuzhinë, në dhomën e fjetjes, në hapsirën për punë, në lojë etj. | Nxënësitë dijnë të përshtetn në jetën në konvikte shkollore<br>Nxënësitë dijnë të vishen si duhet dhe kryejnë detyra të përbashkëta |
| **Edukimi për mirësjellje dhe përshtatja kulturore** | - Identifikimi i fjalëve për mirësjellje: ju lutem, urdhëroni, më falni, falëmnderit etj.<br>- Falënderimi në ndihmën e tjetërkujt, përshëndetja gjatë ardhjes dhe shkuarjes së edukatores, personelit, drejtorit, vizitorëve etj.<br>- Përshëndetja e personit të njohur gjatë takimit ( në shkallë, në rrugë, në oborr etj.)<br>- Përshëndetja me prindërit dhe të afërmit gjatë vizitave të ndryshme<br>- Lirimi i vendit më të vjetërve,<br>- Shprehitë e nxënësve që midis veti të sillen mirë, të mos shtyhen gjatë rreshtimit, të mos rrahen, të mos e largojnë karrikën e shokut etj.<br>- Sjellja në mënyrë kulturore para tavolinës: mos të vendosen brylat në tavolinë, të mos flitet me gojen plotë, ushqimi të mirret me paisjet për ngrënje, me kujdes të hahet në mënyrë që mos të përlyhen rrobet, mbeturinat të hidhen në vend të caktuar e jo çdo kund etj.<br>- Në racion ushqimor gjatë ditës të shkohet i larë dhe me duar të pastërta, ngadal, mos të vrapohet, pas ushqimit me leje të edukatorit të largohen nga kuzhina. | Nxënësit kuptojnë se çka është mirësjellja dhe si duhet të sillen.<br>Në mënyrë të kulturuar e përshëndesin edukatorin, mësuesin prindin etj.<br>Janë të pastër dhe të kujdesshëm për ushqimin ditor sipas racioneve.<br><br>Njohin dhe kuptojnë sjelljet e pranueshme në mjedisin jetësor dhe sillet konform tyre |
| **Zhvillimi i pavarësisë së fëmijes** | - Aftësimi i fëmijëve për veshje dhe zhveshje të pavarur të rrobave<br>- Aftësimi i fëmijëve për marrjen e ushqimit në mënyrë të pavarur dhe përdorimi në mënyrë të rregullt i mjeteve për ngrënie<br>- Zhvillimi i shprehive për vetëshërbim dhe kthimi i mjeteve të përdorura në vendin e vetë<br>- Njohja e mjeteve të veta, të vendit, dhe rregullave të konviktit shkollor<br>- Njohja e vendeve se ku kalohet rruga në anën tjetër<br>- Formimi i vetëdijes për kujdes të veçant ( në lidhje me përdorimin e shkrepses, mosprekja e barërave, mjetve elektrike, mjeteve që ndizen lehtë etj.)<br>- Ushtrime (stërvitja) se si të kërkohet ndihma në fatkeqësi të ndryshme | Identifikojnë, kuptojnë dhe gjykojnë sjelljet e papranueshme në mjedisin social. |
| | - Vizatimi i formave të rrumbullakta, katrore apo trekëndore (balonet, rrota, rrethojave, | Krijojnë produkte të artit |

| | | |
|---|---|---|
| **Aftësimi për komunikim vizuel** | kukulave, sharrave etj.)<br>- Formësimi i sendeve të thjeshta nga letra, të letrave me ngjyra të ndryshme, leshit, si dhe shumë fryteve të ndryshme të thata si dhe materialeve të ndryshme të afërta sipas interesimeve dhe kurreshtjes të fëmijes.,<br>- Punimi i kolazheve të thjeshta<br>- Aftësimi i fëmijëve për vlerësimin estetik duke i krahasuar punimet e veta me të tjerët ( zhvillimi i kritikës dhe vetëkritikës ). | figurativ me mjete e materiale të ndryshme<br>Krahasojnë produktet e artit figurativ për nga përmbajtja, madhësia, ngjyra, pozita e elementeve etj |

**Aktiviteti:Edukimi higjieniko-shëndetësor dhe fizikë ( 17 orë në vit )**

**Objektivat:**

- Identifikimi i kushteve për rritje dhe zhvillim normal të fëmijes dhe zhvillimi i shprehive higjienike
- Pasurimi i njohurive elementare higjienike dhe njohja e veshjeve të përshtatshme për ushtrimet fizike
- Zhvillimi i rregullt i lëvizjeve fillestare dhe koordinimi i lëvizjeve të trupit, duarve, këmbëve, drejtëpeshimit
- Shpjegimi për kapacitetin vital të mushkërive të cilat zvoglohen për shkak të pasivitetit të organeve shqiptuese
- Njohja, kuptimi dhe aplikimi i masave themelore të sigurisë së shëndetit fizik
- Inkurajimi për pavarësinë e fëmijëve në higjienën personale dhe në kujdesin e shëndetit të tyre

**Për realizimin e këtyre objektivave duhet kërkuar:**

- Zhvillimi i shprehive kulturo-higjienike te fëmijet ( edukatorëve, kuzhinierëve, servueseve,e të tjerëve)
- Zgjedhja e mobiljeve të përshtatëshme (sipas madhësisë dhe ngjyrës) dhe i mjeteve përkatëse ( sipas moshës)
- Sigurimi i ushqimit të shëndosh dhe shpërndarja e barabart e aktiviteteve dhe e kohës pushimit
- Veshja e fëmijëve në mënyrë praktike dhe të thjeshtë dhe përshtatja sipas kushteve të motit
- Mbajtja e rregullt e bashkëpunimit me mjekun dhe së paku dy here në vitë të bëhet kontrollimi sistematik i fëmijëve
- Sigurimi i kushteve të përshtatëshme higjienike sipas rregullave dhe normave për entet parashkollore
- Faktorët natyror: dielli, ajri, uji ( së paku tri orë në ditë në ajër të pastër, në diell sa më shumë kur është e mundur, pastrimi i trupit sipas regjimit të konviktit shkollor)

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| **Zhvillimi i shprehive fillestare të higjienës** | - Larja e duarve para dhe pas ngrënjes, larja e fytyrës në mëngjes, larja e dhëmbëve, krehja e flokëve, larja e tërë trupit dhe e flokëve një here në javë dhe sipas nevojës; mirëmbajtja e higjienës dhe mirëmbajtja e flokëve, gojës, duarve; përdorimi i faculetave<br>- Pirja e ujit apo e lëngjeve bëhet vetëm me goten personale,<br>- Përdorimi i peshëqirit dhe brushës së dhëmbëve personale,<br>- Larja e pemëve, përdorja e drejtë e mjeteve sanitare dhe larja e duarve pas përdorimit.<br>- Palosja e rrobave para gjumit, vendosja e këpucëve në vend të caktuar, ecja vetëm me papuqe. | Fëmija dinë të mbaj higjienën personale me mjetet e veta personale, bie në gjum dhe zgjohet nga gjumi në kohë të caktuar, mbanë të pastërta rrobat dhe veshmbathjet personale. |

| | | |
|---|---|---|
| | - Kujdesi ndaj fëmijëve që frikohen nga errësira, ndaj atyre që i thithin gishtat e dorës, dhe ndaj atyre që përmirren gjatë natës.<br>- Veshja, mbathja, larja e fytyrës dhe e duarve, krehjen e flokëve pas etj.<br>- Kujdesi për mos spërkatje të dyshemes dhe bërja me dije se çfar fatkeqësije mund vijë nëse i rrëshqet këmba në dyshemen e lagur<br>- Emërtimi i mjeteve që përdoren për higjienë, si dhe përdorimi i tryre në mënyrë të drejtë.<br>- Shprehia që fëmijët të jenë gjithmonë të pastërt, dhe me kujdes t'i ruajnë gjërat e veta, (kompletin higjienik, lojërat, etj)<br>- Vendosja e lojërave në vendet e veta. | Dijnë për:<br>Kujdesjes dhe mirëmbajtje të dyshemesë<br>Emërton mjetet për higjienën<br>Kanë shprehitë për pastërti dhe për ruajtje të gjërave personale |

**Aktiviteti:Koha e lirë dhe rekreacioni** **( 35 orë në vit )**

**Objektivat:**

- Inkurajimi për zhvillim trupor dhe motorik
- Inkurajimi për zhvillimin gjuhësor dhe i komunikimeve tjera për përdorimin efikas dhe kreativ të gjuhës, që më vonë të ndihmoj në lexim dhe shkrim
- Organizimi i kohës së lirë (forcimi i shëndetit, shetitja në ajër të pastër, socializimi i fëmijës me rrethin social), fitimi i përvojave të reja, zhvillimi i dashurisë ndaj natyrës etj,
- Njoftimi me njerëz të rrethinës ku jeton,
- Organizimi i lojrave argëtuese në forma të ndryshme,
- Pasurimi i jetës emocionale, nxjerrja nga vetmia, krijimi i atmosferës së mirë në shoqëri, zhvillimi i të menduarit,
- Zhvillimi i të folurit përmes mimikës dhe shenjave identifikuese nga çdo situatë e paraqitur.

| **TËRËSITË TEMATIKE** | **PËRMBAJTJET** | **REZULLTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| **Lojërat** | - Lojërat për ushtrime të të dëgjuarit,<br>- Lojërat krijuese (" muratimi" me katror me ngjyrëra, "udhëtimi" me tren apo autobus, ndërtimi i shumë formave në zall, fëmijët vajzat e përmbajnë punën e nënave të tyre, renditja e fryteve të ndryshme, ) ,<br>- Imitimi i situatave nga jeta e përditshme apo nga vizioni tyre. Nga ajo se si luan fëmija, si e organizon lojen, si i shfrytëzon lojërat, edukatori nxjerrë shumë përvoja se si fëmija ndihet në mjedisin e tij, a është i vetmuar, si i kupton marëdhëniet midis vetit dhe të tjerëve etj.<br>- Çka është mirë të dijmë për fëmijën që të zbatojmë tretmanin edukativ adekuat,<br>- Lojërat didaktike dhe lojrat për zhvillimin e të folurit (shfrytëzohen për ushtrimin e të vërejturit, të mbajturit në mend, imagjinatën, elasticiteti i mekanizmit foljor, foto çifte, foto dhe materiale të ndryshme për bashkim dhe shkatrrim, domino, konstruktori, shkopinjë, katrore, lojërat për zhvillimin e formave të ndryshme të organeve të aparatit të të folurit, fryerja e balonave etj.<br>- Lojëra për zhvillimin e shqisave të vërejtjes ( njohja e ngjyrërave dhe formave të ndryshme, madhësive dhe vendit të mjetit)<br>- Lojërat për zhvillimin e paraqitjeve dhe kuptimeve matematikore ( numrimi i gjësendeve për rreth, | Fëmijët dijnë të luajnë me lojëra kreative dhe nxjerrin mesazhin edukativ të tyre.<br><br>Imitojnë personazhet e lojërave të ndryshme dhe identifikojnë personazhet me shokët e grupit apo të klasës.<br><br><br><br><br><br><br><br>Njeh shprehjet matematikore |

| | | |
|---|---|---|
| | numrimi i katrorëve, shkopinjëve dhe gjësendeve tjera, sa herë e gjuajmë topin, sa herë lartë dhe sa herë poshtë etj.) ; (këto lojëra në të njejtën kohë nevojiten edhe si ushtrime për leximin e të shprehurit me gojë).<br>- Lojëra për gjetjen e mbishkrimeve të ndryshme nga figura të ndryshme. | (numërimin, pak, shumë, lartë, poshtë, përpara, prapa, i gjatë, i shkurtër, i madh, i vogël etj) |
| **Shetitjet dhe vizitat** | - Shetitjet në rrethinën e afërt ku fëmija i vëzhgon sendet dhe dukuritë natyrore, si dhe ndryshimet që ndodhin me to në kushte të ndryshme kohore (pranverës, verës, vjeshtës apo dimrit, para dite, pas dite)<br>- Shetitjet në rrethinë më të largët ( ushtrime të ndryshme të tolerancës dhe njohja e jetesës në rrethinën e vetë), fëmijet dërgohen në park, kopsht zoologjik, në fusha sportive, në natyrë, në stacion hekurudhor dhe të autobusëve etj.<br>- Vizita e teatrit të kukullave,<br>- Vizita e kinemave ,<br>- Vizita e bibliotekës,<br>- Vizita e monumenteve historike dhe kulturore (psh: Vizita e muzeut të Lidhjes së Prizrenit etj)<br>- Vizita e ekspozitave rë ndryshme<br>- Vizita e kopshteve të fëmijëve ( dhe vizita tjera nëse ka nevojë)<br>- Vizitë stadiumit të qytetit etj. | Fëmijët njohin stinët e vitit dhe dinë se si ndodhin ndryshimet kohore.<br>Organizimi i vizitave për fëmijë për zgjërimin e njohurive të tyre<br>Organizimi i vizitave të ndryshme kolektive me fëmijët në atë mënyrë që ata të jenë të bashkuar në rresht dhe në grupe të vogla. |

**Aktiviteti: Edukimi për punë dhe detyrat e punës** **( 17 orë në vit )**
**Objektivat:**

- Inkurajimi për kërshëri, shpirt hulumtues, intuitë dhe imagjinatë dhe zhvillim të mendimit të pavarur
- Përshkrimi dhe përgatitja psiqike të fëmijës për kryerjen e detyrave të ardhëshme ( në fillim në bazë të lojes, e pastaj aftësimi që loja të diferencohet nga aktiviteti i punës së veçant)
- Identifikimi i shprehive për vetëshërbim,
- Planifikimi i ndihmës gjatë punës së të tjerëve
- Identifikimi i zhvillimit të interesimit të fëmijëve për punën e të rriturve;
- Zgjërimi i pavarësisë, durimit, dëshirës dhe kualiteteve të tjera pozitive ;

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| **Bazat fillestare të punës dhe ndihmesa të rriturve** | - Dhënia e ndihmës të rriturve ( dhënja e ndihmës atij që punon , ndihma rreth vendosjes së tavolinës, vendosja e ndonjë mjeti në vend të caktuar, marrja pjesë në përgatitjen e ndonjë aktivitet të përbashkët etj.)<br>- Rregullimi i vendqëndrimit, kujdesi ndaj oborrit të shkollës, kujdesi ndaj shtazëve shtëpiake, rregullimi i veglave të cilat nevojiten gjatë lojës etj.)<br>- Zhvillimi i të folurit përmes gjuhës së shenjave- mimikës dhe gjestikulacionit. | Fëmijët janë të aftë t'i ndihmoj të rriturve.<br>Fëmijët janë të pavarur në disa aktivitete të përditëshme shkollore dhe jashtëshkollore.<br><br>Të folurit përmes gjuhës së shenjave (mimikës dhe gjestikulacionit) |
| **Shprehitë, edukimi dhe zhvillimi i dashurisë ndaj punës** | - Zhvillimi i dashurisë ndaj punës, zhvillimi i shprehive dhe shkathtësive ndaj punës,<br>- Arritja e aftësive organizative dhe praktike nëpërmjet arsimimit teknik bashkëkohor,<br>- Aftësimi për punë të pavarur<br>- Arritja e shprehive që të vlerësohet njeriu që punon dhe prodhon,<br>- Edukimi që të punohet në mënyrë kolektive,<br>- Zhvillimi i ndjenjës së kënaqësisë për punën e vetë dhe suksesin e punës së përbashkët,<br>- Edukimi për qëndrueshmëri, këmbëngulje, disciplinë dhe vetëiniciativë për kryerjen e detyrave të punës,<br>- Shprehia e përdorimit të mjeteve të thjeshta për punë, | Fëmijët dinë rëndësin e punës dhe vlerat e dobitë e sajë<br><br>Fëmijët dijnë për:<br>Edukimin për punë në ekip dhe në grup të madh<br>Edukimin në mënyrë kolektive<br><br>Përdorimin e mjeteve të thjeshta për punë |

## REZYME

Zhvillimi planit dhe programit të punës edukative mbështetet mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së aktiviteteve, ashtu edhe nga parashtrimni i rezultateve të të nxënit. Edukimi i fëmijëve në konvikte konsiston në zhvillimin e aspektit shëndetësor e fizik, emocional, mendor e social të tij. Filozofia e edukimit të fëmijëve në konvikte konsiston në respektimin e karakteristikave të përgjithshme të moshës së tyre. Njëkohësisht afirmohet respektimi i dallimeve individuale midis fëmijëve me potencialin zhvillimor të tyre, cilësinë dhe tempon e zhvillimit, specifikave në të nxënit, nivelit dhe cilësisë së panjohurive, shkathtësive, shprehive të tyre etj. Këto karakterisitika janë kryesisht individuale dhe nga arsyeja sepse i nxisin mikrromjediset sociale të ndryshme në të cilat jeton dhe vepron fëmija, specifikat sociale dhe fizike në familje, ato në institucionet pararshkollore shumë të larmishme, mjedisi shoqëror specifik i fëmijës etj.

Edukimi në konvikte duhet të kuptohet si ndihmë që u jepet prindërve për edukimin e fëmijëve të tyre dhe jo si kompensim për edukimin familjar. Duhet theksuar se një klimë e përshtatshme, e cila do të përkujtonte klimën familjare, nuk varet vetëm nga format organizative dhe nga përmbajatjet e jetës në konvikt, por varet para se gjithash nga njerëzit, të cilët do të jenë në gjendje të shkaktojnë atmosferë të përshtatshme dhe sitsuata të volitshme, të ngajshme me ato në familje edhe pse as edhe vetë familja nuk është gjithmonë në gjendje që të krijojë klimë të përshtatshme!

Për një zhvillim sa më të gjithanshëm të personalitetit të fëmijëve në konvikt është i nevojshëm mjedisi konviktor që ofron ngrohtësi, dashuri dhe siguri. Qoftë edhe konvikti më modern me gjithë kujdesin e tij pedagogjik, psikologjik, mjekësor e social, nuk mund të menjanojnë mungesat në zhvillimin social e emocional, në qoftë se nuk siguron një klimë të tillë edukimi, e cila përmbush nevojat e nxënësve.

Edukimi në konvikt do të duhej të imitonte edukimin në familje dhe të krijohen situata dhe pozita që janë të ngjajshme me jetën në familje dhe të kompensohen jo vetëm funksionet edukative të familjes, por duhet të kompensohet edukimi dhe vetë prindërit. Në jetën konviktore ekzistojnë kushte për krijimin e strukturave të fuqishme sociale të grupeve formale, të krijuara prej nesh, të mbështetura dhe që i njohim dhe joformale të krijuara në mënyrë të mëvetësishme dhe shpesh të panjohura për edukatorin, të cilat të shumtën e rasteve shquhen për një shkallë të lartë të lidhshmërisë dhe prandaj kanë një veprim të caktuar si grup mbi individin.

Grupimi sipas kritereve formale ka për qëllim që në jetën e përbashkët të krijohen mundësi për t'u kuptuar sa më mirë ndërmjet vedi dhe që të bëhët një punë sa më e mirë edukative. Pikërisht për këtë shkak, në rastin e formimit të grupeve, duhet të kemi parasysh: gjininë, moshën e fëmijëve, llojin e shkollës, shkallën e intelegjencës, zhvillimin fizik, shkallën e caktuar të çrregullimit emocional dhe të sjelljes dhe gjendjen shëndetësore.

Struktura heterogjene e anëtarëve të grupit, në një anë duhet të mundësojë marrjen për sipër të pozitave e të funksioneve të ndryshme në kuadër të bashkësisë heterogjene, ndërsa, në anën tjetër, duhet të aktualizojë e të konkretizojë problemet e adaptimit dhe kësodore të ofrojë një pikëmbështetje solide për të ushtruar ndikime pedagogjike mbi personalitetin e fëmijës duke pasur parasysh veçoritë e zhvillimit fizik dhe psikik në këtë moshë.

Realizimi i qëllimit të këtij plani dhe programi edukativ do të varet nga puna e përkushtuar e edukatorëve, të cilëve edhe u dedikohet ky plan dhe program i punës edukative.

**ARSIMI FILLOR- NIVELI I PARË**

**Aktiviteti: Nxënësi në konviktin shkollor ( 20 orë në vit )**

**Objektivat e përgjithëshme:**

1 Edukimi sistematik për krijimin e marëdhënjeve në mes të nxënësve.
2 Arritja e shprehive shëndetësoro-higjienike, ruajtja e shëndetit dhe zhvillimi i aftësive fizike.
3 Aftësimi për marëdhënjet shoqërore dhe ndërtimi i marëdhënieve të drejta në mes të nxënësve.
4 Formimi i shprehive të punës, aftësive organizative dhe nxitja e punën krijuese
5 Kultivimi i kulturës së sjelljes, zhvillimi i shijes estetike dhe kreativitetit në punë
6 Aftësimi për aktivitete rekreative në kohë të lirë.
7 Aftësimi për vetë edukim dhe nxitja për punë sistematike.
8 Kujdesi ndaj traditës së konviktit shkollor
9 Aftësimi i nxënësve për të nxënë gjatë gjithë jetës

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| Nxënësi në konviktin shkollor | - Jeta kolektive, sjellja sipas rregullave të konviktit, orijentimi i nxënësve në konvikt: hapësinor dhe kohor (zgjuarja nga gjumi, mëngjesi, përgatitja për fillimin e mësimit, dreka, aktivitete në grupin edukativ, darka, etj.)<br>- Zhvillimi i shprehive disciplinore, respektimi dhe realizimi i kërkesave të edukatorëve dhe të nxënësve kujdestar, | Nxënësitë adaptohen në jetën kolektive dhe dijnë të organizojnë jetën kolektive |
| Sjellja kulturore | - Përshëndetja: midis nxënësve, me edukatorin, me arsimtarët, me mysafirët etj.<br>- Zhvillimi i shoqërisë ( bashkëpunimi i fëmijëve në realizimin e detyrave ditore, menjanimi i mosmarrveshjeve eventuale , etj.)<br>- Zhvillimi i marëdhënieve të drejta: ndaj fëmijëve të vegjël, ndaj të moshuarve dhe ndaj të sëmurëve,<br>- Ndërtimi i marëdhënieve të drejta ndaj: punës dhe detyrave të punës ( kryerja e rregullt e detyrave shkollore, detyrave të konviktit etj.) , ndaj pasurisë ( mjeteve të shkollës, mjeteve për higjienë në konvikt, ruajtja dhe kujdesi ndaj inventarit në vendet ku jetojnë dhe punojnë fëmijët, etj.),<br>- Aftësimi i fëmijëve gjatë komunikimit gojor e cila do t'u nevojitet për kontakte me fëmijë të tjerë të mjedisit, | Nxënësi dinë të përshëndet, të ndihmoj kolegët,të vegjëlit dhe të moshuarit, të ketë marëdhënie të drejtë ndaj detyrave, ndaj pasurisë së shkollës,të kontaktojë me nxënës tjerë të cilët nuk kanë nevoja të veçanta |
| Edukimi në frymën e dashurisë ndaj atëdheut | - Besa dhe bujaria shqiptare<br>- Tradita e të parëve tanë<br>- Personalitetet e shquara të rilindjes kombëtare | Nxënësi dinë se çka është besa, tradita si dhe dinë për shumicën e personaliteteve të shquara të rilindjes |
| Zhvillimi dhe kujdesi i lidhjeve pozitive emotive të fëmijës | - Afërsia e nxënësit me edukatorin ( ndërtimi i besimit dhe liria e të shprehurit që nxënësi t'i drejtohet edukatorit edhe kur ka nevojë për ndihmë),<br>- Kultivimi i dashurisë ndaj prindërve dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes,<br>- Njoftimi me vendin e punës të prindërve ( çka punon, si punon, nderimi ndaj angazhimit të prindërve) | Që nxënësi ka të kultivuar dashurinë ndaj prindërve, edukatorëve dhe pjesëtarëve tjerë të familjes |
| | - Ushtrime me fëmijët me vështirësi në të dëgjuar mbi respektimin e rregullave të komunikacionit, njoftimi me shenjat e komunikacionit të cilat janë parësore për lëvizje të sigurt ( semafori, vijat e bardha për kalim, | Nxënësi dinë shumicën e rregullave të |

| | | |
|---|---|---|
| Aktivitete tjera | trotoari, polici për rregullimin e komunikacionit, etj.)<br>- Kultivimi i sjelljes së mirë gjatë shetitjeve dhe në vende publike<br>- Aftësimi i nxënësve në vlerësimin e sjelljeve negative dhe udhëzimi në kritika shoqërore,<br>- Zgjidhja e vështirësive në lidhje me suksesin e nxënësit,<br>- Organizimi i garave: në dituri, në disciplina, në rezultatet e punës në seksione të ndryshme të aktiviteteve të lira.<br>- Përgatitja për kremte të ndryshme ( rregullimi i hapsirave, veshja e rrobave solemne, pjesëmarrja dhe angazhimi i tyre në program etj.), | komunikacionit<br><br>Nxënësi ka të kultivuar sjelljen e mirë në lokalet shkollore dhe jashtë sajë |

**Aktiviteti:Edukimi intelektual dhe ndërtimi i të folurit dhe gjuhës ( 140 orë në )**

**Qëllimi:**

- Pasurimi i dijes të fëmijëve rreth dukurive natyrore dhe shoqërore
- Zhvillimi i shprehive të punës, motivimi për të arriturat dhe për vetë edukimin.
- Zhvillimi i aftësive intelektuale: kujdesi, imagjinata, ëndrrat, mendimi kritik etj.

**Objektivat:**

- Zhvillimi dhe thellimi i motivacionit për arsimimin dhe kulturën e fëmijëve me nevoja të veçanta
- Zhvillimi i aftësive logjike, të të mbajturit në mend, pavarësisë në reprodukim dhe mendimit apstrakt.
- Zhvillimi i aftësive analitike dhe sintetike të vrojtimit të sendeve dhe të dukurive në natyrë dhe shoqëri.

| TËRËSITË TEMATIKE | VEPRIMTARI ZBATUESE | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| Organizimi i mësimit, vëzhgimi dhe ndihma profesionale<br>Zhvillimi i aktiviteteve praktike<br>Zhvillimi i të folurit dhe pasurimi i leksikonit të nxënësve | - Organizimi i mësimit për zotërimin e e përmbajtjeve nëpërmjet orëve të mësimit – dhe dhënia e udhëzimeve profesionale për mësim dhe përgatitje për shkollë,<br>- Përcjellja e përparimit të nxënësve në shkollë në zhvillimin e të folurit dhe zotërimi i diturive nga lëndet tjera,<br>- Organizimi dhe ndihma profesionale për nxënësë me vështirësi në të nxënë (me angazhimin e mësimdhënësitë special, ekspertit, psikologut, pedagogut, punëtorit social dhe organizimin e mësimit plotësues), | Nxënësit përsërisin dhe zotërojnë njohuritë teorike në praktikë<br>Nxënësit planifikojnë dhe organizojnë aktivitete të ndryshme praktike<br>Organizojnë ndihmën dhe përkrahjen profesionale për nxënësitë me vështirësi në të nxënë |

**Aktiviteti: Edukimi estetik** **( 37 orë në vit )**

**Qëllimi:**

- Zhvillimi dhe formimi i ndjenjës estetike të nxënësit në të gjitha llojet e formave të aktiviteteve në natyrë, në punë, në art, në mesin shoqëror dhe në kohë të lirë;
- Aftësimi i nxënësve në aktivitetin e krijimtarisë estetike në realizimin e nevojave, zhvillimi i ndjenjës dhe formimi i aftësive në mënyrë që jeta dhe puna e tyre të jenë të plotësuarë me përmbajtje të vlerave estetike;

**Objektivat:**

- Zhvillimi i përjetimeve për estetikë dhe vlerësimet për të bukurën
- Formimi i shijes estetike dhe i mendimit kritik për zbulimin dhe shfrytëzimin e të bukurës,
- Organizimi sistematik për krijimtari estetike
- Zhvillimi i aftësive praktike dhe futja e të bukurës në jetën dhe punën e përditshme.

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| Rregullimi estetik i konviktit shkollor: | - Angazhimi i nxënësve në jetën dhe punën estetike në konviktit shkollor,<br>- Estetika e ambientit të punës për rekreacion,<br>- Kultivimi i luleve në hapsirat e konviktit shkollor,<br>- Rregullimi i këndeve për secilin aktivitet, ndihma ndërmjet veti dhe garimi në mes grupeve,<br>- Zhvillimi i sjelljes estetike në kuzhinë, në tavolinë, gjatë shtruarjes së tavolinës, dhe gjatë shërbimit, | Nxënësi është i aftë të perceptojë të bukurën |
| Rregullimi i konviktit shkollor dhe i oborrit që na rrethon | - Tregimi i interesit për të bukurën e ambientit që na rrethon,<br>- Pamja estetike e oborrit shkollor dhe rregullimi i disa pjesëve të tij,<br>- Rregullimi i lulishteve dhe nxitja për të bukurën. | Nxënësit angazhohen në mirëmbajtjen e kopshtit shkollor |
| Nxitja e aftësive për zhvillimin elementar të të vrejturit për të bukurën, në të vërtetën objektive, në natyrë, në punë, në sjellje, në jetën e përditëshme etj. | - Shembulli personal për sjellje të bukur,<br>- Zhvillimi i aftësive të përjetimit për të bukurën në bazë të interesimit të fëmijëve,<br>- Zhvillimi i ndjeshmërisë për dallimin në mes të bukurës dhe të shëmtuarës,<br>- Bukuria e sjelljes në mënyrë individuale, grupore apo kolektive,<br>- Sjellja e mirë në grupin edukativ, në seksione, në lojë apo në gara të përbashkëta.<br>- Bukuria e marëdhënjeve ndërnjerëzore,<br>- Kultivimi i sjelljes së mirë në familje, shkollë, konvikt etj,<br>- Kultivimi i marëdhënjeve të mira të nxënësit ndaj arsimtarit dhe edukatorit | Nxënësi dinë të çmoj sjelljen e mirë dhe të bukurën |
| Nxënësi dhe ndërtimi i sjelljes së mirë | - Vlerësimi i vetive pozitive të nxënësit,<br>- Veshja estetike në raste të veçanta, mbajtja dhe ruajtja e garderobës,<br>- Sjellja e bukur e nxënësve pranë tavolinës, mënyra e të ushqyerit .<br>- Pamja estetike e shkrimit si element i edukimit të mirë,<br>- Zhvillimi i leximit dhe i recitimit të mirë, | Nxënësit dinë të veshen dhe të mbathen si dhe të sillen mirë dhe bukur rreth tavolinës<br>Nxënësit dinë të lexojnë bukur, të recitojnë dhe të shprehen |

| | | |
|---|---|---|
| | - Zhvillimi i mendimit për të shprehurit e bukur,<br>- Zhvillimi i dashurisë ndaj kafshëve,<br>- Prerja e vizatimeve të ndryshme nga fletët me ngjyra dhe ngjitja në fletore,<br>- Përgatitja e sendeve të ndryshme nga plastelina,<br>- Modelime të ndryshme me anë të telit<br>- Dhurata për mësuesin (7 marsi) për nënën (8 marsi) për shokët me rastin e ditëlindjeve (përgatitja dhe paketimi i bukur) vizatime të punuara nga nxënësit | bukur<br><br>Nxënësit dinë të vizatojnë dhe të përgatisin gjëra të ndryshme nga plastelina |
| Vizatimi | - Vizatime sipas zgjedhjes së nxënësve (akuarel),<br>- Vizatimi i ideve të imagjinuara,<br>- Vizatime me motive të ndryshme nga pjesë të gazetave për fëmijë,<br>- Vizatimi i orendive shtëpiake,<br>- Vizatimi i shtazëve shtëpiake | Nxënësit dijnë t'i dallojnë ngjyrërat dhe të vizatojnë sipas motiveve të ndryshme. |
| Manifestime tjera | - Shiqimi i filmave vizatimor dhe vizita e teatrit të kukullave<br>- Shiqimi i filmave dhe vërja në pah e të bukurës<br>- Festimi i ditëlindjes dhe vërja në pah e përjetimeve të bukura<br>- Kujdesi të fëmijëve për vështrim për të mirën gjatë shiqimit të filmave për fëmijë dhe shfaqjeve teatrale<br>- Krijimi i ndjenjës për përjetime të mira gjatë festave të ndryshme shtetërore | Nxënësit komentojnë përmbajtjen e filmave dhe shfaqjeve teatrale |

**Aktiviteti:Koha e lirë dhe rekreacioni** **( 70 orë në vit )**

**Qëllimi:**

- Optimizmi për jetën dhe iniciativa për krijimtari, me të cilën siguron ndikim pozitiv në shëndetin mental dhe fizik
- Zhvillimi dhe formimi i ndjenjës morale të nxënësit në të gjitha llojet e formave

**Objektivat:**

- Formimi i shprehive të nxënësve për shkathtësi të marëdhënieve shoqërore, në kuptim të socializimit të individit,
- Formimi i shprehive te nxënësit për pushim aktiv të përmbushur me lëvizje fizike, sport, lojë dhe vizita të ndryshme
- Zhvillimi i vetëiniciativës dhe individualitetit ( në rrethin ku jeton) nëpërmjet zgjedhjes së lirë dhe i përcaktimit për argëtim apo aktivitet sportiv,
- Identifikimi i zbulimeve me të reja të shkencës dhe teknologjisë, ngjarjet më të reja në vendin tonë, sukseset e njerëzve të ndryshëm të vendit tonë nga puna, jeta sportive dhe zbavitëse,
- Organizimi i garave sportive në nivel rajoni dhe më gjërë
- Organizimi i nxënësve në jetën kolektive
- Identifikimi i ngjarjeve të reja historike të popullit tonë
- Identifikimi i gatishmërisë që me punën e vetë të kontriboj në ndërtimin e vendit tonë,
- Zhvillimi i mendimit te fëmijët që mësimi dhe puna e tyre të jetë detyra e tyre parësore
- Ndërtimi i vetive bazë të moralit ( shoqërorizimit, rregullullave dhe nderimi ndaj të vjetërve)

| **TËRËSITË TEMATIKE** | **PËRMBAJTJET** | **REZULLTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| Lojëra rekreative | - Lojëra me lodra me zë,<br>- Lojëra të vogla shoqërore (lojra me katror, konstruktori i vogël, arqitekti i vogël, elemente për radhitje, radhitja e katrorëve sipas fotove etj.)<br>- Lojërat me lodra lëvizëse ( lodra me mbështjellje),<br>- Lojëra imitative ( në familje, në autobus, imitimi i shtazëve – ecja e arushës, si fluturon zogu, vrapimi i qenit, lehja, etj.)<br>- Lojërat lëvizëse (loja me top, ujku dhe qengji, etj, ),<br>- Shetitjet ( në rrethinë të afërt dhe të largët nga shkolla, në kopsht zoologjik etj),<br>- Seksione sportive ( futboll, hendboll, basketboll, tenis etj),<br>- Seksione kulturo-artistike (ritmike, folklorike,etj)<br>- Grupe dhe seksione në formë të edukimit teknik: seksioni i punës së dorës, grupa e teknikës për të rinjë ( vozitja me biçikletë, rregullimi i shenjave të komunikacionit etj.) | Nxënësit organizojnë lojëra të ndryshme me lodra të ndryshme së bashku me fëmijët tjerë<br><br>**Njohuri mbi organizimin e shetitjeve dhe pikniqeve të nxënësve në përshtatje me moshën dhe kërkesat e tyre** |
| Eukata morale | - Edukimi në frymën e humanizmit,<br>- Përgatitja për jetën familjare,<br>- Edukimi në bashkësi dhe për bashkësinë,<br>- Edukimi në frymën e internacionalizmit,<br>- Formimi i qëndrimit të drejtë ndaj punës,<br>- Formimi i qëndrimit pozitiv ndaj vlerave materiale e shpirtërore | Nxënësitë dijnë se çka është humanizmi dhe jeta në bashkësi. |

**REZYME**

Zhvillimi planit dhe programit të punës edukative mbështetet mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së aktiviteteve, ashtu edhe nga parashtrimni i rezultateve të të nxënit. Praktika është burimi, por edhe fillimi i çdo njohurie dhe gjithnjë paraqitet si kriter i së vërtetës, sepse çdo njohuri e fituar verifikohet në praktikë. Në praktikë përmbajtjet teorike kuptohen më mirë. Veç kësaj, ajo edhe mundëson aftësimin e individit për jetë dhe punë. Prandaj, me të drejtë themi se çdo pjesë e përmbajtjes edukative dhe arsimore që duhet të përvetësohet nga nxënësit, është e lidhur me praktikën, e cila ua bën të mundshme që njohuritë mësimore - edukative të tyre të jenë më të qarta dhe më të kuptueshme.

Kjo etapë e punës edukative, për nga karakteri i veprimeve operativee të saj, është një proces i angazhimit të përbashkët të edukatorit dhe të nxënësve, i cili rrjedh nga vetë karakteri bashkëkohor i organizimit të punës edukative. Mbështetur në këto kërkesa, realizimi i aktiveteve të ndryshme ndodhet në varësi direkte nga përgatitja paraprake e fëmijëve, që zakonisht ka për qëllim integrimin e fëmijëve në punën dhe përmbajtjet e reja të të gjitha aktiviteve në konvikt.

Edukimi në konvikte duhet të kuptohet si ndihmë që u jepet prindërve për edukimin e fëmijëve të tyre dhe jo si kompensim për edukimin familjar. Duhet theksuar se një klimë e përshtatshme, e cila do të përkujtonte klimën familjare, nuk mvarret vetëm nga format organizative dhe nga përmbajatjet e jetës në konvikt, por mvarret para se gjithash nga njerëzit, të cilët do të jenë në gjendje të shkaktojnë atmosferë të përshtatshme dhe sitsuata të volitshme, të ngajshme me ato në familje edhe pse as edhe vetë familja e natyrshme nuk është gjithmonë në gjendje që të krijojë klimë të përshtatshme!

Gjatë përmbushjes së kohës së lirë, posaçerisht duhet të kihet parasysh që aktivitetet të mos jenë të njëllojshme, sepse reduktimi i tyre ndikon negativisht në zhvillimin e personalitetit të të riut dhe në mosorganizim. Kërkesa për organizimin e kohës së lirë nuk duhet të zhvillohet si vazhdim i regjimit të punës së përditshme, duke ua marrë nxënësve lirinë e disponimit të tërë kohës së lirë, sepse ajo duhet të kuptohet si lëmë e jetes së tyre e shkarkuar nga detyrimet, por mbi baza demokratike dhe të vetëdijshme të bashkëpunimit, që të jetë në funksion të drejtimit dhe të zhvillimit të plotë të personalitetit të nxënësit.

Për një zhvillim sa më të gjithanshëm të personalitetit të nxënësit në konvikt është i nevojshëm mjedisi konviktor që ofron ngrohtësi, dashuri dhe siguri. Qoftë edhe konvikti më modern me gjithë kujdesin e tij pedagogjik, psikologjik, mjekësor e social, nuk mund të menjanojnë mungesat në zhvillimin social e emocional, në qoftë se nuk siguron një klimë të tillë edukimi, e cila përmbush nevojat e nxënësve.

Edukimi në konvikt do të duhej të imitonte edukimin në familje dhe të krijohen situata dhe pozita që janë të ngjajshme me jetën në familje dhe të kompensohen jo vetëm funksionet edukative të familjes, por duhet të kompensohen edhe vetë prindërit. Në jetën konviktore ekzistojnë kushte për krijimin e strukturave të fuqishme sociale të grupeve formale, të krijuara prej nesh, të mbështetura dhe që i njohim dhe joformale të krijuara në mënyrë të mëvetësishme dhe shpesh të panjohura për edukatorin, të cilat në shumtën e rasteve shquhen për një shkallë të lartë të lidhshmërisë dhe prandaj kanë një veprim të caktuar si grup mbi individin.

Grupimi sipas kritereve formale ka për qëllim që në jetën e përbashkët të krijohen mundësi për t'u kuptuar sa më mirë ndërmjet vedi dhe që të bëhët një punë sa më e mirë edukative. Pikërisht për këtë shkak, në rastin e formimit të grupeve, duhet të kemi parasysh: gjininë, moshën e fëmijëve, llojin e shkollës, shkallën e intelegjencës, zhvillimin fizik, shkallën e caktuar të devijimit, sjelljen dhe gjendjen shëndetësore.

Gjatë drejtimit të bisedave të lira dhe individuale ose në grupe duhet dhënë sqarime, nxitje për nxënës, kurse me punën praktike konkrete ata t'i orientojmë për planifikimin dhe organizimin e kohës së lirë të tyre. Prandaj, me qëllim që koha e lirë e nxënësve të ketë karakter sa më të organizuar, ajo nuk duhet të bie në kundërshtim me kërkesat elementare që shtron kjo fushë edukative e angazhimit të nxënësve.

**SHKOLLA E MESME E ULËT – NIVELI I DYTË**

**Aktiviteti:Edukimi intelektual dhe ndërtimi i të folurit dhe gjuhës ( 140 orë në vit )**

**Qëllimi:**

- Zhvillimi i shprehive të punës, motivimi për të arriturat dhe për vetë edukim.
- Zhvillimi i aftësive intelektuale: kujdesi, imagjinata, mendimi kritik etj.

**Objektivat:**

- Zhvillimi dhe thellimi i motivacionit për arsimimin dhe kulturën e nxënësve me nevoja të veçanta
- Zhvillimi i aftësive logjike, të të mbajturit në mend, pavarësisë në reprodukim dhe mendimit apstrakt.
- Zhvillimi i aftësive analitike dhe sintetike të vrojtimit të sendeve dhe të dukurive në natyrë dhe shoqëri.

| TËRËSITË TEMATIKE | VEPRIMTARI ZBATUESE | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| Organizimi i mësimit, vëzhgimi dhe ndihma profesionale<br><br>Zhvillimi i të folurit dhe pasurimi i leksikonit të nxënësve | - Organizimi i mësimit për zotërimin e e përmbajtjeve nëpërmjet orëve të mësimit – dhe dhënja e udhëzimeve profesionale për mësim dhe përgatitje për shkollë,<br>- Përcjellja e përparimit të nxënësve në shkollë në zhvillimin e të folurit dhe zotërimi i diturive nga lëndet tjera,<br>- Organizimi dhe ndihma profesionale për nxënës me vështirësi në nxënie (me angazhimin e mësimdhënësit special, ekspertit, psikologut, pedagogut, punëtorit social dhe organizimin e mësimit plotësues), | Nxënësit përsërisin dhe zotërojnë njohuritë teorike në praktikë<br><br>Nxënësit përfitojnë nga organizimi i përkrahjes dhe ndihmës profesionale. |

**Aktiviteti: Nxënësit me vështirësi në të nxënë** **( 35 orë në vit )**

**Objektivat:**

- Të kuptuarit e detyrave dhe përgjegjësive i çdo anëtari të grupit edukativ dhe identifikimi i përgjegjësive për sukseset e grupit në përgjithësi
- Njohja e procedurave të përcaktimit të grupeve për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme
- Analizimi i shprehive në planifikimin e punës, të çmuarit e kohës dhe detyrat e dhëna të kryhen me kohë
- Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i punës individuale dhe të tjerëve
- Zhvillimi i mendimit për ruajtjen e pasurisë së vetë dhe të shkollës
- Kuptimi i rregullave shkollore dhe kujdesi për pasurinë individuale dhe të shkollës

| **TËRËSITË TEMATIKE** | **PËRMBAJTJET** | **REZULLTATETE PRITSHME** |
|---|---|---|
| Mësimnxënia<br><br>Teknikat e punës<br><br>Format e punës<br><br>Mjetet mësimore | - Çfarë duhet bërë që suksesi ynë të jetë i mirë<br>- Aplikimi i masave nxitëse ( garime, dhurata, lëvdata)<br>- Organizimi i ndihmës dhe bashkëpunimit ndërmjet nxënësve për arritje të suksesit më të mirë,<br>- Përmirësimi i punës dhe i diciplinës në konviktin tonë<br>- Fitimi i njohurive të nxënësve dhe vlerësimi i tyre në mënyrë sistematike<br>- Angazhimi në aktivitete praktike për vrojtim konkret, koncentrim të vemendjes, formim të përfytyrimeve, dhe të koncepteve të qarta e të plota në mbështetje të të cilave do të zhvillohet të menduarit analitik dhe abstrakt<br>- Përcaktimi dhe harmonizimi i mënyrës së punës më mundësitë dhe kapacitetet e nxënësve, në mënyrë që mësimi të ketë tipare të formës individuale të punës mësimore<br>- Identifikimi dhe dallimi i profesioneve të reja nga profesionet e vjetra<br>- Ndikimi i shkencës dhe teknologjisë në jetën e përditëshme të njerëzve | Nxënësi angazhohet për përmirësimin e suksesit individual<br><br>Nxënësit dinë të planifikojnë organizimin e mësimit praktik dhe janë në gjendje t'i aplikojnë shkathtësitë për punë gjatë gjithë jetës |

**Aktiviteti:Edukimi intelektual dhe ndërtimi i të folurit dhe i gjuhës ( 35 orë në vit )**

**Qëllimi:**

- Aftësimi i nxënësve në të shprehurit gojor dhe drejtëshkrimor me gjuhën standarde letrare

**Objektivat:**

- Zhvillimi i shprehive për vetëarsimim
- Aftësimi i nxënësve për shfrytëzim të kohës në mënyrë racionale
- Motivimi dhe zhvillimi i ambicieve për thellim të arsimimit
- Aftësimi i nxënësve për shprehje logjike të mendimeve dhe me fjali korekte

| **TËRËSITË TEMATIKE** | **PËRMBAJTJET** | **REZULLTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| Të folurit permes shenjave dhe të shkruarit në funksion të pëvetësimit të leksikut | - Të kuptuarit (e nxënësit) në rëndësinë e ndërtimin të të folurit dhe shfrytëzimi i ndihmësëve të dëgjimit<br>- Leximi i librave të ndryshëm,<br>- Zbatimi i diturive të nxënësve në praktikë<br>- Aftësimi i nxënësve në komunikimin verbal<br>- Ushtrime në krijimtari të të menduarit në përmbajtjen e caktuar përmes lojës<br>- Ushtrime të të mbajturit në mend si kusht për mësim të suksesshëm<br>- Paraqitja logjike e mendimeve të nxënësve dhe të shprehurit e fjalive në mënyrë logjike | Identifikimi i nxënësve të cilët kanë nevojë për aparatin individual të dëgjimit.<br><br>Kupton rëndësinë e praktikës profesionale dhe të komunikimit gojor.<br><br>Aplikimi i njohurive në praktikë |
| Zhvillimi i shprehive për vetëdukim | - Të shërbyerit me gazeta dhe emisione televizive me qëllim të përfitimit të diturive të reja,<br>- Ndërtimi dhe zhvillimi i vetëdijes së njeriut në rolin që ka, rreth ndryshimit dhe përmirësimit të kushteve për jetë në rrethinën e vetë | Nxënësi dinë të shërbehet me informacione nga TV dhe gazeta të ndryshme |
| Shfrytëzimi racional të kohës | - Krijimi i shprehive për mësim,<br>- Planifikimi i të mësuarit,<br>- Pavarësimi gjatë kryerjes së detyrave shtëpiake | Nxënësi dinë të planifikojë kohën për mësim dhe për detyra të shtëpisë |
| Motivimi dhe zhvillimi i ambicieve për të ardhmen | - Thellimi dhe zgjërimi i arsimimit si faktor i rendësishëm për zgjedhjen e profesioneve të tyre,<br>- Forcimi i vetëdijes për rendësinë e dijes dhe zhvillimit të sajë për jetën e çdo njeriu | Nxënësi është i përgatitur dhe i vetëdijshëm për sfidat që e presin gjatë jetës |

**Aktiviteti: Edukata morale** **( 10 orë në vit )**

**Objektivat:**

- Ndërtimi i të menduarit te nxënësit me nevoja të veçanta për qëndrimin, vështrimin dhe shprehitë ndaj raporteve humane ndërmjet njerëzve, vlerave njerëzore dhe në fushën e punës dhe të jetës,
- Njoftimi i nxënësve me nevoja të veçanta me jetën dhe punën në konvikte shkollore,
- Bashkëpunimi i konviktit me mjedise të tjera shoqërore ( me shkolla tjera në rajon, institucione qeveritare dhe joqeveritare),
- Zhvillimi i humanizmit,
- Formimi dhe zbatimi i shprehive të sjelljeve pozitive në raste solemne

| **TËRËSITË TEMATIKE** | **PËRMBAJTJET** | **REZULLTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| Edukimi me frymën e dashurisë ndaj atëdheut | - Nderimi i flamurit dhe himnit kombëtar,<br>- Nderimi i invalidëve të luftës,<br>- Përkujdesja dhe dashurija ndaj heronjëve të luftës<br>- Gara në mësim dhe diciplinë në mes grupeve | Nxënësi dinë përmendësh himnin kombëtar<br>Nxënësi është i kujdesshëm ndaj invalidëve dhe heronjëve të luftës |
| Edukimi për marëdhënie humane në mes të gjinive dhe sjellja kulturore | - Jeta dhe puna në kolektive të përziera ( marëdhënie e mirëfilltë ndaj gjinisë së kundërt, solidarizimi dhe ndihma ndërmjet veti,<br>- Leximi i pjesëve të ndryshme nga librat për fëmijë, gazetave të ndryshme, dhe shiqimi i filmave për fëmijë,<br>- Përkujdesja dhe ndihma ndërmjet veti në kohën e parapubertetit dhe pubertetit | Nxënësi dinë të kujdeset ndaj shokut në kohën e duhur në raste kur i duhet ndihma shokut |

**Aktiviteti: Edukimi për punë dhe detyrat e punës** **( 17 orë në vit )**

**Objektivat:**

- Formimi dhe forcimi i vetëdijes se puna është e domosdoshme dhe është kënaqësi,
- Zhvillimi i aftësive për vlerësimin e kualitetit të punës së vetë dhe të tjerëve,
- Zhvllimi i disciplines së vetëdijshme të punës, këmbëngulësisë dhe qëndrimit korrekt,
- Aftësimi për realizimin e planifikuar të operacioneve punuese dhe zbulimi i ideve të reja,
- Përdoprimi i mjeteve të thjeshta për punë, njohja me të arriturat teknike bashkohore,
- Aftësimi për punë të pavarur me detyra të lehta,

| **TËRËSITË TEMATIKE** | **PËRMBAJTJET** | **REZULLTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| Të vetëshërbyerit e | - Kujdestaria në kuzhinë, dhomë fjetjeje, klasë, banjo etj- kryerja e detyrave të dhëna | Nxënësi bënë kujdestari ku |

| | | |
|---|---|---|
| nxënësve në konviktin shkollor | - Rregullimi i hapsirave dhe i ormanit<br>- Mirëmbajtja e librave dhe mjeteve mësimore,<br>- Shfrytëzimi i gjilpërës dhe penit për qepje të ndryshme<br>- Rregullimi i tavolinës dhe servimi i ushqimit,<br>- Larja e drejtë e enëve,<br>- Mirëmbajtja e mirë e rrobave dhe mbathjeve | caktohet dhe të dijë të manipulojë me gjësende të përditëshme |
| Kujdesi ndaj enterierit të konviktit | - Mirëmbajtaja në gjendje të mirë: dhomave të gjumit, klasave, banjove, etj<br>- Mirëmbajtja e luleve në hapsira të ndryshme ( ujitja, shumimi etj) ,<br>- Rregullimi i hapsirave për raste solemne etj | Nxënësi përkujdeset dhe mirëmban hapësirat shkollore dhe konviktore |
| Kujdesi ndaj eksterierit të konviktit | - Mirëmbajtja e pastërtisë së oborrit: mirëmbajtja e luleve dhe e gjelbrimit në kopshtin shkollor dhe konviktor<br>- Rregullimi i qosheve të ndryshme për më të rinjët, | Nxënësi kujdeset dhe mirëmban oborrin e shkollës dhe të konviktit |
| Aktivitete tjera | - Elementet fillstare të thurjes dhe qëndisjes,<br>- Përpunimi i mozaiqeve nga materiale të ndryshme,<br>- Punimi i zbukurimeve për vitin e ri,<br>- Punimi i tapiserive, | Nxënësi përgatitë mjete dhe elemente të ndryshme për punë |

**Aktiviteti: Edukimi higjieniko-shëndetësor dhe fizikë** **( 10 orë në vit )**

**Objektivat:**

- Formimi i shprehive për higjienë personale dhe të përgjthëshme
- Zhvillimi i personalitetit të shëndosh, stabil emocionalisht dhe të qëndrueshëm,
- Identifikimi i ndryshimeve tek nxënësit në periudhën e pubertetit
- Formimi i qëndrimeve kritike ndaj dukurive të cilat negativisht ndikojnë në shëndet ( pirja e duhanit, alkooli, mjetet narkotike etj.),

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| Zhvillimi i shprehive higjienike dhe shëndetësore | - Mirëmbajtja e pastërtisë së trupit,<br>- Mirëmbajtja e pastërtisë së hapsirave në shkollë dhe konvikt,<br>- Ngrohja dhe ajrosja e rregullt e të gjitha hapsirave në shkollë dhe konvikt<br>- Shprehitë e higjienës personale dhe mirëmbajtja e ambientit,<br>- Të rinjët dhe rreziku nga pirja e duhanit, alkoolit dhe i supstancave të ndryshme narkotike dhe rreziku për trupin e tyre | Nxënësi mbanë pastërtinë personale dhe kolektive.<br>Ka shprehi të higjienës personale, të mirëmbajtjes së ambientit,<br>Dinë për shumë mjete të cilat e rrezikojnë trupin e tyre |

**Aktiviteti: Edukimi estetik** **( 35 orë në vit )**

**Objektivat:**

- Vlerësimi sistematik dhe përjetimi i të mirës në mesin ku nxënësit jetojnë dhe punojnë,
- Formimi dhe përkujdesja e shijes estetike si pjesë e pandarë e strukturës psiqike të nxënësit, stilit dhe sjelljes së tij, mënyrës së jetës dhe marëdhënies së tij ndaj punës,
- Formimi dhe përkujdesja estetike për vetëveten, ndaj të tjerëve dhe ndaj kohës së lirë,
- Zhvillimi i sjelljes së mirë dhe kulturore gjatë ecjes me shokët dhe me njerëzitë tjerë,
- Zhvillimi i dispozitave estetike dhe motivimi në aktivitete estetike,
- Përhapja e diturive për vlerat estetike dhe krijimtarive artistike.

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| Rregullimi estetik - enterierit të shkollës dhe konviktit nga nxënësit | - Ndërtimi i ndjeshmërisë për rregullimin e hapsirave punuese në shkollë dhe konvikt,<br>- Punimi dhe shpërndarja e ilustrimeve të ndryshme në shkollë dhe konvikt,<br>- Zbukurimi i objektit shkollor dhe konviktit,<br>- Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbruara rreth shkollës dhe konviktit,<br>- Zhvillimi i shprehive për ushqim të rregullt,<br>- Ndryshimet në organizmin e njeriut gjatë kohës së pubertetit<br>- Përdorimi i mjeteve preventive kundër sëmundjeve ngjitëse (vakcinimi),<br>- Mënyra e veshjes sipas situatave të ndryshme,<br>- Aftësimi për vetëmbrojtje | Nxënësi dinë të çmoj estetikën e enterierit të shkollës dhe të konviktit<br>Nxënësi dinë të rregullojë të zbukurojë dhe të mirëmbajë: kuzhinën, ambulancën, koridoret dhe oborrin e shkollës dhe konviktit<br>Dinë për ndyshimet që bëhen në trupin e njeriut gjatë kohës së pubertetit<br>Me vetëdëshirë shkon te dentisti dhe në kontrollime mjekësore-vakcinime |
| Ushtime sistematike trupore dhe marrja me sport | - Ushtrime të rregullta në mëngjesë<br>- Ushtrime të lehta trupore<br>- Pjesëmarrja dhe aktiviteti në gara të ndryshme sportive,<br>- Pjesëmarrja në akcione të ndryshme shëndetësoro-higjienike | Nxënësi organizon ushtrime sistematike trupore dhe është aktiv në gara sportive |
| Rregullimi i ambientit të shkollës dhe konviktit | - Gjelbërimi i sipërfaqeve rreth shkollës dhe konviktit,<br>- Ngritja e lulishteve dhe mirëmbajtja e tyre gjatë vitit,<br>- Mbjellja e bimëve dhe drunjëve zbukurues,<br>- Ndërtimi i ndijshmërisë estetike për ruajtje dhe mirëmbajtje të sipërfaqes dhe gjelbërimit të shkollës | Nxënësi dinë të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara në mjedisin shkollor |
| Nxënësit dhe mërësjellja | - Mirësjellja në çfaqje të ndryshme publike, dhe udhëtimet e nxënësve,<br>- Zhvillimi i ndjeshmërisë për dëshirën e nxënësve që jetën e tyre ta përmbushin me të mira,<br>- Ndërtimi i sjelljes së mirë te nxënësit gjatë kohës së ardhjes së musafirëve në shkollë dhe në shtëpi | Nxënësi dinë të mirësillet në çdo situatë, dhe dinë të përjetojë të bukurën, komiken dhe tragjiken |
| Vizatimi | - Vizatime sipas shijes së nxënësve,<br>- Vizatime sipas temave të caktuara,<br>- Vizatime të vazeve me lule, dhe ambienteve të ndryshme të natyrës,<br>- Të shprehurit dhe krijimi i të bukurës përmes vizatimit, vlerësimi i vizatimeve të nxënësve,<br>- Ilustrimi i përrallave me anë të vizatimit, | Nxënësi dinë të vizatojë sipas shijes dhe temave të caktuara |

| | | |
|---|---|---|
| Vizita në kopshtin zoologjik | - Vizita kopshtit zoologjik dhe vështrimi i shtazëve,<br>- Shiqimi i filmave dhe shfaqjeve të ndryshme dhe vënja në dukje e të bukurës dhe të shëmtuarës | Nxënësi dinë t'i dallojë shtazët e egra dhe shtazët shtëpiake |

**Aktiviteti: Koha e lirë dhe rekreacioni** **( 35 orë në vit )**

**Objektivat:**

- Krijimi i shprehive që një pjesë e kohës së lirë t'i kushtohet pushimit aktiv ( lojrave, sportit, shetitjeve etj.),
- Përmbushja e kohës së lirë me aktivitete të ndryshme
- Zhvillimi dhe kujdesi ndaj shokëve, ndërveprimi dhe bashkëpunimi nëpërmjet lojës dhe argëtimit,
- Zhvillimi i mëtejshëm i vetë inicijativës, individualitetit dhe veprimtarisë ( gjatë lojës, organizimit të aktiviteteve, pranimi i humbjes në mënyrë sportive )

| **TËRËSITË TEMATIKE** | **PËRMBAJTJET** | **REZULLTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| Lojërat rekreative | - Lojëra argëtuese<br>- Lojëra me lodra me zë me qëllim të ushtrimit të dëgjueshmërisë dhe ritmit, ( për nxënësë me vështirësi në dëgjim)<br>- Lojëra të zhdërvjellësisë ( ndërmjet dy zjarreve, lojëra të ndryshme në borë, vrapimi me lugë në gojë në të cilën është e vendosur veja)<br>- Organizimi i shetitjeve | Nxënësi merr pjesë aktive në lojërat dhe aktivitete të ndryshme |
| Pjesëmarrja në seksionet sportive | - Hobi- aktivitetet nëpërmjet seksioneve sportive dhe garimi në kuadër të shkollës dhe me shkollat tjera ( basketboll, futboll, hendboll, tennis, shah, etj,) | Nxënësi dine të organizohet në gara |
| Aktivitete kulturo-artistike dhe zbavitjeje | - Seksionet ritmike, letrare, figurative, recituese etj.<br>- Organizimi i vallëzimeve për nxënës dhe pjesëmarrja e nxënësve nga shkollat tjera, | Nxënësi merr pjesë në seksione të cilat e nxisin kurreshtjen e tij |
| Grupet dhe seksionet nga fusha e TIK-ut | - Formimi i grupeve të natyralistëve të rinjë<br>- Njohja e relacioneve në mes të teknologjisë dhe shoqërisë - sot, në të kaluarën dhe në të ardhmen<br>- Identifikimi i nevojave dhe i mundësive që mund të arrihen me ndihmën e aktivitetit teknologjik<br>- Njohuri të përgjithëshme për kompjuterin | Nxënësit dinë të përgjigjen për punën që bëjnë në seksione dhe grupe të vogla dhe të mëdha |

**REZYME**

Nxënësit me aftësi të kufizuara kanë një koncept të drejtë dhe pozitiv për mësimet që zhvillohen në shkollë, ata punojnë shumë për përvetësimin e njohurive shkollore të cilat i shikojnë si një mundësi reale për integrimin e tyre në jetën normale, e vlerësojnë punën në shkollë si shumë interesante dhe kanë një pikëpamje reale lidhur me aftësitë dhe progresin e tyre.

Shkollat speciale në përbërjen e vetë kanë nxënës të kategorive të ndryshme lidhur me paaftësitë, duke filluar nga çrregullimet e palcës cerebrale, me paaftësit në të dëgjuar dhe në të shikuar, me paaftësi mendore të lehtë ( si dëmtime të lehta të trurit apo vonesa në zhvillim), apo me probleme në sjellje dhe në të nxënit. Nevojat e këtyre fëmijëve dhe në të njëjtën kohë edhe reagimet emocionale të tyre ndaj shkollës dhe edukatorëve të tyre janë të ndryshme.

Duhet theksuar se në shumë fëmijë të kësaj kategorie, mund të kuptosh se kanë forca, që në rastet kur ndodhen para problemeve, kërkojnë vetë rrugë të ndryshme zgjidhjeje për të dalë nga situata. Këto rrugë zgjidhjeje mund të jenë ndihma e edukatorëve për të cilën shprehen shumica e tyre, ndihma e prindërve, ndihma nga shokët, të afërmit, pse jo edhe duke vepruar sipas mënyrës së vet, pa u shqetësuar shumë për këtë gjë.

Një gjë është e qartë, nga edukatorët që punojnë me këta nxënës të kësaj kategorie që të punojnë në mënyrë të tillë, që të stimulojnë vazhdimisht këta fëmijë për t'u rritur vetërespektin, vetëbesimin, për t'u krijuar një psikologji të suksesit dhe jo të dështimit. Për të arritur këtë, edukatorët duhet që detyrat dhe objektivat që shtrojnë përpara vetes t'i kenë në nivelin e përshtatshëm dhe të mundshëm për t'u realizuar nga fëmijët.

Këta fëmijë kërkojnë një mënyrë të veçantë organizimi të aktiviteteve të ndryshme, metoda dhe teknika speciale në përputhje me dëshirat dhe mundësitë e tyre. Shpesh burim i shqetësimeve të tyre bëhen aktivitetet që nuk i kuptojnë, që kanë material teorik më shumë se veprimtari praktike, aktivitetet që zhvillohen me metoda tradicionale etj. Aktivitetet e zhvilluara me mjete ilustrimi, veprime praktike, jashtë mësimore të shkollës janë më afër dëshirave të këtyre nxënësve.

Formimi i vetëdijës për vete dhe për të tjerët, sjellja në parimin e disiplinës së vetëdijshme janë veçori të personalitetit të tërsishëm, të integruar. Nxënësi do të zhvillohet si tërsi vetishë dinamike në zhvillim atëherë kur i bëhet e mundshme të inkuadrohet në aktivitetet edukative në mësim dhe jashtë mësimit, individualisht dhe në grup, kur nxitet të shfaq dhe të zhvillojë potencialet e tija njerëzore fizike ( skeletin dhe muskujt, sistemin e organeve të brendshme, shqisat, aftësitë sensitive motorike, sistemin nervor vegjetativ dhe qendror etj.), kur inkuadrohet në punët e përbashkëta që ndihmojnë zhvillimin e aftësive të tija intelektuale ( shqisat për të vërejtur, përceptuar, mbamendjen, aftësitë për të mneduar në mënyrë të pavarur dhe të drejtë), që duke bashkëvepruar me të tjerët të humanizojë temperamentin dhe botën e tij emotive, të formojë karakter të fortë moral- dëshirën, vendosmërinë, qëndrueshmërinë në punë, përgjegjësinë ndaja vetes dhe të tjerëve, ndaj mjeteve të punës, ndaj përmbajtjeve dhe rezultateve të saja. Personaliteti i integruar është personalitet i zhvilluar në pikëpamje të gjithanshme, jo doemos, por nëse ka potenciale të larta nejrëzore- edukative.

Praktika është burimi, por edhe fillimi i çdo njohurie dhe gjithnjë paraqitet si kriter i së vërtetës, sepse çdo njohuri e fituar verifikohet në praktikë. Në praktikë përmbajtjet teorike kuptohen më mirë. Veç kësaj, ajo edhe mundëson aftësimin e individit për jetë dhe punë. Prandaj, me të drejtë themi se çdo pjesë e përmbajtjes edukative dhe arsimore që duhet të përvetësohet nga nxënësit, është e lidhur me praktikën, e cila ua bën të mundshme që njohuritë mësimore-edukative të tyre të jenë më të qarta dhe më të kuptueshme. Edukimi në konvikte duhet të kuptohet si ndihmë që u jepet prindërve për edukimin e fëmijëve të tyre dhe jo si kompensim për edukimin familjar. Duhet theksuar se një klimë e përshtatshme, e cila do të përkujtonte klimën familjare, nuk varet vetëm nga format organizative dhe nga përmbajatjet e jetës në konvikt, por varet para se gjithash nga njerëzit, të cilët do të jenë në gjendje të shkaktojnë atmosferë të përshtatshme dhe sitsuata të volitshme, të ngajshme me ato në familje edhe pse as edhe vetë familja e natyrshme nuk është gjithmonë në gjendje që të krijojë klimë të përshtatshme!

Për një zhvillim sa më të gjithanshëm të personalitetit të nxënësit në konvikt është i nevojshëm mjedisi konviktor që ofron ngrohtësi, dashuri dhe siguri. Qoftë edhe konvikti më modern me gjithë kujdesin e tij pedagogjik, psikologjik, mjekësor e social, nuk mund të menjanojnë mungesat në zhvillimin social e emocional, në qoftë se nuk siguron një klimë të tillë edukimi, e cila përmbush nevojat e nxënësve.

**PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME TË LARTË (Niveli 3)**

**Aktiviteti: Edukimi intelektual dhe zhvillimi i të folurit dhe i gjuhës ( 140 orë në vit )**

**Qëllimi:**

- Zhvillimi i shprehive të punës, motivimi për të arriturat dhe për vetë edukim.
- Zhvillimi i aftësive intelektuale: kujdesi, imagjinata, mendimi kritik etj.

**Objektivat:**

- Zhvillimi i dashurisë për arsim të përhershëm dhe formimi i shprehive për vetëarsimimin e nxënësve,
- Zhvillimi i aftësive për të mbajturit në mend në mënyrë logjike, reprodukimi i pavarur dhe mendim abstrakt,
- Aftësimi i nxënësve për vrojtim analitik dhe sintetik të sendeve dhe dukurive në natyrë dhe shoqëri,
- Aftësimi i nxënësve për zbatim të metodave racionale, efikase, ekonomike dhe teknike
- Ndërtimi i aftësive te nxënësit, që të shprehurit në të shkruar dhe gojor të jetë në mënyrë letrare,
- Zhvillimi dhe thellimi i motivimit për arsimimin dhe kulturën e nxënësve me nevoja të veçanta
- Formimi i të vërejturit shkencor të nxënësve, në mënyrë realiste
- Zhvillimi i aftësive analitike dhe sintetike të vrojtimit të sendeve dhe të dukurive në natyrë dhe shoqëri.

| TËRËSITË TEMATIKE | VEPRIMTARI ZBATUESE | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| Organizimi i mësimit, vëzhgimi dhe ndihma profesionale<br><br>Zhvillimi i të folurit dhe pasurimi i leksikonit të nxënësve | - Organizimi i mësimit për zotërimin e përmbajtjeve nëpërmjet orëve të mësimit – dhe dhënia e udhëzimeve profesionale për mësim dhe përgatitje për shkollë,<br>- Përcjellja e përparimit të nxënësve në shkollë në zhvillimin e të folurit dhe zotërimi i diturive nga lëndet tjera,<br>- Organizimi dhe ndihma profesionale për nxënës me vështirësi në nxënie ( me angazhimin e mësimdhënësitë special, ekspertit, psikologut, pedagogut, punëtorit social dhe organizimin e mësimit plotësues), | Nxënësit përsërisin dhe zotërojnë njohuritë teorike në praktikë<br><br>Nxënësitë me vështirësi në të nxënë me përkrahjen profesionale arrijnë suksese. |
| Motivimi dhe të nxënit gjat gjithë jetës | - Të shprehurit e rregullt në të folur dhe në të shkruar<br>- Interesimi i nxënësve për dije dhe shkencë, e veqanërisht ndaj fushave të caktuara shkencore<br>- Njohja e nxënësve për mënyrën e të nxënit: të mbajturit në mend dhe harresa<br>- Të dëgjuarit e vëmendëshëm dhe koncentrimi në aktivitete të ndryshme<br>- Analiza e të nxënët: të nxënit e ndar dhe në kohë, hartimi i skicave, skemave dhe teknikave e të udhëhequrit të shënimeve gjatë aktiviteteve,<br>- Forcimi i motivimit: biseda individuale me nxënësit tek të cilët vërehet aftësia e ulët e gjatë punës,<br>- Motivimi, aftësimi i nxënësve në të nxënit aktiv duke i përdorur aftësitë e tij krijuese,<br>- Njohja e nxënësve me profesione të ndryshme dhe motivimi tyre në përzgjedhjen e profesionit jetësor,<br>- Zhvillimi i ineresimit për vetë arsimim dhe vetë edukim, | Nxënësi inerpreton dhe shprehet mirë ( në gjuhën e shenjave) dhe në të shkruar<br>Identifikimi i kërkesave të nxënësve për avansimin e dijes në lëmenjë të caktuar të të arriturave të shkencës dhe teknikës<br><br>Identifikimi i profesionit që nxënësin e përcjellë gjatë gjithë jetës |

| | | |
|---|---|---|
| | - | |
| Aftësimi i nxënësve për punë të pavarur | - Burimet e informatave: shfrytëzimi i fjalorëve; bibliografive speciale; enciklopedive të ndryshme etj.<br>- Shfrytëzimi i literatures plotësuese në mënyrë të pavarur për nxënie<br>- Aftësimi i nxënësve për metodat kërkimore- shkencore (fusha të ndryshme në aplikimin e teknikës, fizikës, dhe lëmenjëve tjera që i interesojnë nxënësit)<br>- Analiza e rezultateve të punës dhe njoftimi i prindërve | Nxënësi zgjedh probleme duke shfrytëzuar lieraturë të ndryshme |

**Aktiviteti: Edukimi moral** **( 35 orë në vit )**

**Objektivat:**

- Zhvillimi i qëndrimeve pozitive të nxënësit në aspektin moral,
- Bashkëpunimi me mjediset shoqërore: politike, ekonomike dhe me organizata tjera qeveritare dhe joqeveritare
- Përgatitja e nxënësve për jetë dhe punë (përgatitja për punë në familje, marëdhëniet ndërmjet gjinive, etj)

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| Ndërtimi i kolektivitetit në mes të nxënësve me plotësimin e detyrimeve të punës dhe disciplinës si formë e organizimit të aktiviteteve | - Zgjedhja e organeve të duhura në shkollë dhe konvikt nga ana e nxënësve<br>- Organizimi i kujdestarisë së nxënësve,<br>- Nderimi i shokut dhe vënja në pah e shoqërisë<br>- Të menduarit - vetëkritika dhe kritika si kategori etiko-morale<br>- Ndërtimi i mendimit për barazi dhe puna reciproke intelektuale dhe fizike si normë moralo etike<br>- Disciplina si formë bazë e të qenurit si kolektiv ( problemet e të adaptuarit në diciplinë, reagimet sipas adaptimeve në disa kërkesa etike) | Nxënësit dijnë përzgjedhin organet e veta, nderojnë shokët, disciplina është në nivel të duhur<br><br>Ndërtojnë marëdhënje të mira në rrethin social |
| Zhvillimi i pjekurisë dhe personalitetit emotiv | - Zhvillimi i vetëdijes morale<br>- Ndërtimi i ndijshmërisë morale për të kuptuarit e dinjitetit, drejtësisë, përgjegjësisë, etj,<br>- Komponentet e vetëdijes morale (intelektuale, emocionale dhe kolektive)<br>- Pjekuria emocionale dhe kolektivi i nxënësve (integrimi i brendëshëm, sjelljet racionale etj),<br>- Përvoja morale nga filma të shikuar, analiza e personazheve<br>- Reagimi ndaj shkeljeve të ligjit dhe frenimi moral | Çdo nxënës dinë se çka është morali, dinjiteti, drejtësia, përgjegjësia<br><br>Nxënësi dijnë të reagojnë ndaj shkeljeve të ligjit |
| Dallimi në mes gjinive dhe komponenta shoqëroro-morale e marëdhënjeve në mes tyre | - Dallimi në konstituimin e trupit dhe strukturës së sistemit nervor,<br>- Dallimi në mes gjinive; gjëndrrat për tajim të brendëshëm,<br>- Të kuptuarit e gjinive nëpër shekuj,<br>- Mosha e pjekur dhe edukimi seksual,<br>- Komponentet biologjike, shoqërore, morale dhe marëdhënjet në mes gjinive (sëmundjet e seksuale transmetuese dhe pasojat), devijimet seksuale.<br>- Higjiena seksuale si mbrojtëse fizike dhe psiqike e shëndetit,<br>- Dashuria rinore, simpatia, argëtimi, | Çdo nxënës dinë për strukturën e sistemit nervor, për moshën e pjekur, higjienën dhe sëmundjet transmetuese seksuale, |

| | | |
|---|---|---|
| | - Themelimi i bashkësisë familjare | |
| Bashkëshortësia si institucion moral dhe social në edukimin e fëmijëve | - Bashkëshortësia si institucion moralo-social,<br>- Bashkëshortësia në mesin tonë,<br>- Ndërtimi i themeleve emocionale të bashkëshortësisë stabile; harmonia bashkëshortore,<br>- Jeta e përbashkët bashkëshortore,<br>- Martesa si institucion bazë social dhe edukativ i fëmijëve,<br>- Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijëve në shoqërinë tonë,<br>- Zhvillimi prenatal dhe problemet e fëmijërisë së hershme,<br>- Kushtet të cilat ndikojnë në afirmimin e personalitetit;<br>- Analiza e ndodhive nga shtypi ditor, revistave të ndryshme dhe burimeve tjera informative për bashkëshortësinë, për edukimin seksual, literaturë profesionale etj. | Nxënësit dinë se familja është institucion bazë për edukimin e fëmijëve<br>Nxënësit identifikojnë të drejtat bashkëshortore, të drejtat e fëmijëve dhe detyrat e tyre |
| Ndërtimi i ndjeshmërisë për drejtimin e mendimit moral | - Te vërejturit moral ( ndjeshmëria e dinjitetit, drejtësisë dhe përgjegjësisë)<br>- Reagimi në sjellje negative të të tjerëve dhe dhënja e kritikave,<br>- Vetëkontrolla ne situata te sprovave morale<br>- Ndertimi i të menduarit për vetëkontrollin (frenime) morale dhe modele te ndryshme të sjelljes<br>- Kritika dhe vetëkritika | Çdo nxënës është kritik dhe vetëkritik ndaj situatave të ndryshme dhe sprovave morale |
| Edukimi ne frymën e dashurisë ndaj mëmëdheut | - Zhvillimi i dashurisë ndaj vendlindjes<br>- Aspektet historike te formimit te popullit tonë<br>- Rëndësia e paqës në botë | Nxënësit dinë se çka është patriotizmi, dhe paqja në botë si dhe historinë e popullit të vetë. |

**Aktiviteti: Edukimi për punë** **( 17 orë në vit )**
**Objektivat:**

- Zhvillimi i dashurisë ndaj punës dhe formimi i shprehive për punë
- Zhvillimi i ndjeshmërisë së lumturisë dhe kënaqësisë për suksesin personal
- Zhvillimi i të menduarit për punën si domosdoshmëri për zhvillim dhe mbijetim të shoqërisë dhe të individit,
- Krijimi i shprehive dhe shkathtësive punuese,
- Ndërlidhja e arsimimit teknikës bashkëkohore me krijimtari punuese,
- Aftësimi sistematik për krijimtari aktive

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| Zhvillimi i dashurisë ndaj punës | - Njoftimi i nxënësve për rëndësinë historike të punës,<br>- Njoftimi i nxënësve për rëndësinë e punës mendore e cila është bërë zotëruese e natyrës,<br>- Krijimi i nevojës te nxënësit për punë të bukur dhe kualitet (përsëritja e operacioneve të punës në mënyrë që të fitohet kualiteti i kënaqur),<br>- Lavdërimi dhe dhuratat për ata nxënës të cilët gjatë punës së tyre janë treguar shok te mirë, që e kanë çmuar punën e të tjerëve, kanë qenë të angazhuar për dhënjen e ndihmës për nxënës të rinjë etj, | Nxënësi dinë se puna e bukur dhe kualiteti i mirë janë bazë për avancim të mëtejshëm |
| Të vetësherbyerit e nxënësve në shkollë dhe në konvikt | - Angazhimi i nxënësve rreth përgatitjes dhe rregullimit të dhomave te fjetjes, dhe hapësirave të përbashkëta etj,<br>- Kyqja dhe angazhimi i nxënësve në organizimin e punës në kuzhinë dhe në lokale tjera të përbashkëta,<br>- Kyqja dhe angazhimi i nxënësve në gara vjetore për higjienë të konviktit dhe shkollës me rastin e ndonjë feste | Nxënësit dinë të rregullojnë dhe të organizojnë punën në çdo aspekt të jetës në konvikt |
| Krijimi i shprehive pozitive dhe planifikimi i punës | - Të praktikuarit e nxënësve për përcjelljen e rrjedhjes së secilit proces të punës, dhe të aplikuarit e punës sistematike,<br>- Shprehija e nxënësve për punë të obligueshme në kohë të caktuar si dhe planifikimi i obligimeve të punës,<br>- Sendërtimi i nxënësve për arritje të suksesit sa më të madh dhe realizimin estetik të prodhimit,<br>- Aktivizimi i nxënësve për përcjelljen e punës së nxënësve të rinj, ndihmojnë në planifikimin dhe kryerjen e detyrave të përditëshme,<br>- Formimi i grupeve punuese dhe organizimi i aksioneve të rregullimit të enterierit dhe eksterierit të shkollës dhe konviktit ,<br>- Angazhimi i nxënësve si udhëheqës të grupeve punuese, seksioneve etj, | Nxënësit planifikojnë orarin punës në mënyrë sistematike<br><br>Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin në mënyrë reciproke |
| Puna dhe edukimi bashkëkohor teknik | - Angazhimi i nxënësve punë të dobishme shoqërore: në punëtori të ndryshme të shkollës ( rrobaqepësi, fotolaborator, etj),<br>- Njoftimi i nxënësve me principet fillestare të prodhimtarisë dhe teknologjinë e punës<br>- Zhvillimi krijues i nxënësve ndaj punës dhe theksimi i nevojës për punë hulumtuese theksimi i nevojës për punë hulumtuese, | Nxënësit dinë të punojnë punë të ndryshme në punëtori të shkollës si dhe kanë çasje kritike ndaj procesit të punës |

| | | |
|---|---|---|
| | - Organizimi i vizitës kolektive në panaire të ndryshme për teknikën bashkëkohore dhe për të arriturat teknologjike | |

**Aktiviteti: Edukimi shëndetësoro-higjienik dhe fizik ( 35 orë në vit )**
**Objektivat:**

- Zhvillimi i mëtejshëm i shprehive për higjienë personale dhe të përgjithëshme
- Formimi i shprehive për shfrytëzim të drejtë të pushimit,
- Dhënja e ndihmës profesionale për dukuritë të cilat ndikojnë negativisht në shëndetin e nxënësve ( alkoolizmi, narkomania etj,)
- Aftësimi i nxënësve për ndonjë disiplinë në fushën e edukates fizike ( instruktor sportiv, refer, organizator i rekreacioneve etj,)

| **TËRËSITË TEMATIKE** | **PËRMBAJTJET** | **REZULLTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| Zhvillimi i shprehive higjienike dhe shëndetësore | - Zhvillimi i shprehive dhe të kuptuarit e drejtë për mirëmbajtje të higjienës personale,<br>- Sëmundjet e ndyshme ngjitëse dhe shfrytëzimi i preventivës kundër tyre<br>- Çka duhet bërë kur dikush është i sëmurë, ku duhet të drejtohet dhe si<br>- Ndërtimi i qëndrimeve të forta te nxënësitë, si dhe mendimi kritik për ruajtjen e shëndetit dhe mospërfillja e fenomeneve të cilat e dëmtojnë shëndetin personal (alkooli, narkomania, etj.),<br>- Higjiena shkollore<br>- Mënyra e të ushqyerit dhe llojet e ushqimeve si nevojë themelore për njeriun,<br>- Higjiena e ushqimit,<br>- Ushqimi i rregullt dhe rendësia e tij,<br>- Llojet kryesore të ushqimeve | Nxënësit në mënyrë sistematike formojnë shprehi higjienike dhe kujdesen për mirëmbajtjen e higjienës personale |
| Ushtrime sistematike trupore dhe marrja me sport | - Ushtrime individuale dhe në qifte të ndryshme formësimi, pa rekvizita dhe me rekvizita<br>- Vrapimi në vend apo ushtrime të tjera të cilat janë të lehta,<br>- Ushtrime të rregullta individuale apo kolektive të mëngjesit,<br>- Ushtrime të elementeve për basketboll, hendboll, futboll, tenis, gjuajtje, etj,<br>- Ushtrime dhe organizime të ndryshme të lojërave sportive si përgatitje për pjsëmarrje në gara të ndryshme,<br>- Gjimnastika estetike,<br>- Lëndimet e ndryshme në sport (mjeku) | Nxënësi dinë për rëndësinë e ushtrimeve trupore |
| Lëvizjet elementare motorike | - Aktivitete në lëvizje të zakonshme si: ecje, vrapim, kërcim, zvarritje, hedhje, kapje, ngjitje, zbritje, bartje etj.<br>- Aktivitete në ambiente të përshtatshme për zhvillimin trupor dhe shëndetin e fëmijëve në natyrë, në sipërfaqe të relievit të ndryshëm, dhe në ambiente të hapura e të mbyllura.<br>- Aktivitete për lëvizjet e tërë trupit, të gjymtyrëve, krahut, dorës, shuplakës, gishtave të dorës, shputës së këmbës etj. | Nxënësi dinë të bëjë koordinim e lëvizjeve të trupit, duarve, këmbëve dhe drejtëpeshimin e trupit. Harmonizon koordinimin e lëvizjeve me kërkesat e kohës, ritmit dhe hapësirës. Identifikon lëvizjet e natyrshme të thjeshta kah |

| | | |
|---|---|---|
| Lojërat imituese | - Zhvillon aktivitete të ecjes, qëndrimi në këmbë, ecje në vijë të drejtë, ecje në vijën e lakuar dhe rrethore.<br>- Imitimi i shtazëve, shpendëve, imitimi i njerëzve dhe mjeteve mekanike përmes vëzhgimit vizuel. | lëvizjet më të përbëra si ecje, vrapimi, kërcimi, rrokullisja, zvarritja, ngjitja, zbritja etj. Organizon lojërat elementare dhe sportet e ndryshme të mjedisit jetësor të nxënësit. |

**Aktiviteti: Edukimi estetik** **( 35 orë në vit )**
**Qëllimi:**

- Krahasimi i krijimtarisë estetike në të kaluarën dhe sot
- Identifikimi i aktiviteteve krijuese, aktivitete krijuese në mënyrë individuale puna dhe koha e lirë me përmbajtje dhe vlerë estetike,
- Zhvillimi i ndjenjës estetike në institucionet shkollore dhe konvikte
- Ndërtimi i ndjenjës estetike në mes tragjikës dhe komikës, të shëmtuares dhe të bukurës, të mirës dhe të keqes, me vlera dhe pa vlera, artistike dhe jo artistike, etj,

| TËRËSITË TEMATIKE | PËRMBAJTJET | REZULLTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| Rregullimi estetik i shkollës dhe konviktit | - Rregullimi i kuzhinës për ushqim,<br>- Rregullimi i dhomave në stilin e ambientit shtëpiak( lule, fotografi, punëdore individuale),<br>- Rregullimi i herëpasëhershëm i ambienteve për ndonjë rast të veçant,<br>- Rregullimi i ambienteve për pritje të mysafirëve ( prindërve,të afërmëve, etj.), | Çdo nxënës di të rregulloj në mënyrë estetike ambientin konviktor |
| Rregullimi i rrethinës së shkollës dhe konviktit | - Dhënja e iniciativës për gjelbrim të oborrit të shkollës dhe konviktit,<br>- Pjesëmarrja në punën e rregullimit të hapsirës rreth shkollës dhe konviktit<br>- Ruajtja dhe kultivimi i luleve në hapsirat rreth shkollës dhe konviktit,<br>- Formimi i shprehive që ndijshmëria estetike të bartet tek të rinjët | Nxënësi dinë të planifikojnë rregullimin e hapsirës shkollore dhe konviktore |
| Bazat e sjelljes së mirë | - Vlerësimi i punimeve estetike të nxënësve,<br>- Bazat e sjelljes së mirë: sjellja e mire bashkëkohore, nxitja e nxënësve në sjellje të mirë në konvikt, në vende publike, etj,<br>- Vlerësimi dhe të çmuarit e ndonjë drame, komedije, tragjedije etj,<br>- Analizimi i ndonjë emisioni televiziv apo ndonjë filmi etj,<br>- Dhuratat dhe llojet e dhuratave sipas kërkesave të nxënësve,<br>- Organizimi i pritjeve: llojet e pritjeve, shkrimi i ftesave, organizimi dhe realizimi i pritjeve,<br>- Mirësjellja në netët argëtuese, vallëzime etj,<br>- Mirësjellja në mjetet e udhëtimit tokësor dhe në vende tjera publike, | Nxënësitë dijnë dhe identifikojnë sjelljeve të mira në konvikt jashtë konviktit |
| Sajimi i sjelljeve estetike | - Identifikimi i vlerave estetike të përfituara më parë dhe pasurimi i mëtutjeshëm i personalitetit | |

| | | |
|---|---|---|
| te nxënësit<br><br>Formimi i shprehive estetike tek nxënësit | të nxënësit me kualitete të reja,<br>- Formimi i mendimit për aftësitë estetike, kusht për zhvillimin e personalitetit të gjithanshëm,<br>- Formimi i nevojës së përhershme për përjetimin e së bukurës,<br>- Organizimi i seksioneve të aktiviteteve të lira,<br>- Organizimi i ekspozitave në shkollë dhe jasht sajë,<br>- Paraqitja, mbështetja, përcjellja e informatave, urimet dhe ngushllimet tek shokët e grupit,<br>- Shkrimi i vizitëkartave, letrave, telegrameve, informacioneve zyrtare, shpalljeve, pllakatave etj,<br>- Zhvillimi i shprehive të nxënësit për pamje estetike,<br>- | Nxënësitë dijnë të interpretojnë vlerat estetike në mjedisin konviktor |
| Vizatimi dhe fotografitë | - Vizatimi me ngjyra temperë në bazë të shikimit të ndonjë objekti,<br>- Vizatimi sipas zgjedhjes së lirë të nxënësit,<br>- Punimi i vizatimeve me kashtë apo në pëlhurë,<br>- Punimi i vizatimeve me anë të shtypjes së bimëve,<br>- Punimi i tapiserive dhe punëve tjera të dorës,<br>- Mbledhja e fotografive dhe rregullimi në albume (historike, gjeografike etj), | Nxënësit dinë të vizatojnë dhe t'i çmojnë vizatimet e punuara nga shokët e grupit |
| Aktivitete të tjera | - Shikimi i filmave të ndryshëm sipas kërkesave të nxënësve<br>- Shikimi i shfaqjeve të ndryshme teatrale duke e spikatur të mirën,<br>- Organizimi i shetitjeve dhe eskurzioneve të ndryshme me karakter mësimor | Nxënësit dine të organizojnë ekskursione me karakter mësimor |

**Aktiviteti: Koha e lirë dhe rekreacioni** **( 70 orë në vit )**

**Aktiviteti:**

- Organizimi i jetës shoqërore, besimi dhe respekti reciprok ndaj shokëve të grupit (kolegëve)
- Besueshmëria reciproke, respektimi i shokut etj,
- Ndërtimi i shprehive për shfrytëzim të dobishëm të kohës së lirë, të pushimit, zbavitja- rekreacioni në zhvillimin e personalitetit të nxënësit,
- Zhvillimi i vetëiniciativës tek nxënësit për programimin e kohës së lirë

| **TËRËSITË TEMATIKE** | **PËRMBAJTJET** | **REZULLTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| Pushimi i nxënësve në konviktin shkollor | - Nxitja e nxënësve në shfrytëzimit pushimit ditor ( marrja me aktivitete sportive, me hobi të ndryshëm etj),<br>- Organizimi i garave të ndryshme sportive,<br>- Organizimi i lojërave të ndryshme shoqërore,<br>- Marrja me aktivitete teknike, shërbyese dhe prodhuese,<br>- Organizimi i nxënësve për mënyrën e relaksimit mendor dhe fizik,<br>- Njohja e nxënësve me kushtet themelore të pushimit të mirë përtrirja e energjisë për punë, intoksinimi i organizmit, gjatësia e pushimit etj, | Nxënësi dinë të shfrytëzojë në mënyrë racionale kohën e lirë |
| Argëtimi i nxënësve në jetën konviktore | - Organizimi i aktiviteteve argëtuese për nxënësit<br>- Organizimi i netëve relaksuese,<br>- Organizimi i punës për argëtimin e nxënësve me shfaqje humoristike,<br>- Puna në seksione: ritmike, i shahut, futbollit, basketbollit, të punës së dorës etj,<br>- Organizimi i garave sipas aktiviteteve të nxënësve . | Nxënësi dinë të organizohet në aktivitete të ndryshme argëtuese |
| Zhvillimi i komponenteve fizike, intelektuale, morale, estetike dhe teknike | 1. Organizimi i lojërave rekreativo dëfryese ( vrapimi, kërcimi, hipja, zhagimi, vëzhgimi etj), lojëra grupore në borë dhe akull, skijimi, vizita e ndonjë loje jashtë shkolles, shetitja në park, organizimi i garave në sport etj,<br>2. Identifikimi i vendeve për lexim në kohë të lirë, blerja e librave dhe revistave në bazë të kërkesës së nxënësve, rregullimi i panos për punime më të mira të nxënësve, udhëzimi i nxënësve për librat që iu interesojnë dhe ku mund ti gjejnë, vizita e ekspozitave të ndryshme, etj,<br>3. Organizimi i diskutimeve në fushën e marëdhënieve njerëzore, bisedat për moralin, çka është kuptimi i jetës së njeriut, për ndershmërinë etj,<br>4. Organizimi dhe paraqitja e krijimtarive të nxënësve, biseda për artin figurativ, parqitja e vizatimeve artistike të nxënësve, organizimi i punës së seksioneve dramatike, të artit dhe seksioneve të ndryshme në fusha krijuese të nxënësve, aktivizimi i nxënësve në rregullimin e enterierit dhe eksterierit të shkollës, shikimi i filmave të ndryshëm dokumentar dhe organizimi i diskutimeve në lidhje me ngjarjet në këta filma.<br>5. Komponenta punuese: organizimi i vizitave në fabrika prodhuese, leximi i literaturës teknike, shikimi i emisioneve lidhur me popullaritetin e teknikës, punimi i sendeve nga kashta, nga fryte të ndryshme të pyjeve, nga kartoni, nga letra, nga teli i hollë, etj | Nxënësi ka njohuri për aktivitete në fushën: fizike, intelektuale, morale, estetike dhe teknike.<br>Nxënësi dinë për seksionet e aktiviteteve të lira.<br>Kanë njohuri prej vizitave në ndërmarrjet e ndryshme prodhuese |

**REZYME**

Zhvillimi planit dhe programit të punës edukative mbështetet mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së aktiviteteve, ashtu edhe nga parashtrimni i rezultateve të të nxënit.

Nxënësit me aftësi të kufizuara kanë një koncept të drejtë dhe pozitiv për mësimet që zhvillohen në shkollë, ata punojnë shumë për përvetësimin e njohurive shkollore të cilat i shikojnë si një mundësi reale për integrimin e tyre në jetën normale, e vlerësojnë punën në shkollë si shumë interesante dhe kanë një pikëpamje reale lidhur me aftësitë dhe progresin e tyre.

Shkollat speciale në përbërjen e vetë kanë nxënës të kategorive të ndryshme lidhur me paaftësitë, duke filluar nga çrregullimet e palcës cerebrale, me paaftësit në të dëgjuar dhe në të shikuar, me paaftësi mendore të lehtë ( si dëmtime të lehta të trurit apo vonesa në zhvillim), apo me probleme në sjellje dhe në të nxënit. Nevojat e këtyre fëmijëve dhe në të njëjtën kohë edhe reagimet emocionale të tyre ndaj shkollës dhe edukatorëve të tyre janë të ndryshme.

Duhet theksuar se në shumë fëmijë të kësaj kategorie, mund të kuptosh se kanë forca, që në rastet kur ndodhen para problemeve, kërkojnë vetë rrugë të ndryshme zgjidhjeje për të dalë nga situata. Këto rrugë zgjidhjeje mund të jenë ndihma e edukatorëve për të cilën shprehen shumica e tyre, ndihma e prindërve, ndihma nga shokët, të afërmit, pse jo edhe duke vepruar sipas mënyrës së vet, pa u shqetësuar shumë për këtë gjë.

Një gjë është e qartë, nga edukatorët që punojnë me këta nxënës të kësaj kategorie që të punojnë në mënyrë të tillë, që të stimulojnë vazhdimisht këta fëmijë për t'u rritur vetërespektin, vetëbesimin, për t'u krijuar një psikologji të suksesit dhe jo të dështimit. Për të arritur këtë, edukatorët duhet që detyrat dhe objektivat që shtrojnë përpara vetes t'i kenë në nivelin e përshtatshëm dhe të mundshëm për t'u realizuar nga fëmijët.

Këta fëmijë kërkojnë një mënyrë të veçantë organizimi të aktiviteteve të ndryshme, metoda dhe teknika speciale në përputhje me dëshirat dhe mundësitë e tyre. Shpesh burim i shqetësimeve të tyre bëhen aktivitetet që nuk i kuptojnë, që kanë material teorik më shumë se veprimtari praktike, aktivitetet që zhvillohen me metoda tradicionale etj. Aktivitetet e zhvilluara me mjete ilustrimi, veprime praktike, jashtë mësimore të shkollës janë më afër dëshirave të këtyre nxënësve.

Formimi i vetëdijës për vete dhe për të tjerët, sjellja në parimin e disiplinës së vetëdijshme janë veçori të personalitetit të tërsishëm, të integruar. Nxënësi do të zhvillohet si tërsi vetishë dinamike në zhvillim atëherë kur i bëhet e mundshme të inkuadrohet në aktivitetet edukative në mësim dhe jashtë mësimit, individualisht dhe në grup, kur nxitet të shfaq dhe të zhvillojë potencialet e tija njerëzore fizike ( skeletin dhe muskujt, sistemin e organeve të brendshme, shqisat, aftësitë sensitive motorike, sistemin nervor vegjetativ dhe qendror etj.), kur inkuadrohet në punët e përbashkëta që ndihmojnë zhvillimin e aftësive të tija intelektuale ( shqisat për të vërejtur, përceptuar, mbamendjen, aftësitë për të mneduar në mënyrë të pavarur dhe të drejtë), që duke bashkëvepruar me të tjerët të humanizojë temperamentin dhe botën e tij emotive, të formojë karakter të fortë moral- dëshirën, vendosmërinë, qëndrueshmërinë në punë, përgjegjësinë ndaja vetes dhe të tjerëve, ndaj mjeteve të punës, ndaj përmbajtjeve dhe rezultateve të saja. Personaliteti i integruar është personalitet i zhvilluar në pikëpamje të gjithanshme, jo doemos, por nëse ka potenciale të larta nejrëzore- edukative.

Në këtë cikël të shkollimit të mesëm të lartë, tek nxënësit duhet zgjëruar njohuritë lidhur me zhvillimin anatomiko-fiziologjik të të rinjëve, me theks të veçant të aktiviteteve dhe të raporteve ndërgjinore. Si djemtë ashtu edhe vajzat duhet informuar dhe ushtruar të sillen në mënyrë kulturore ndaj njëri-tjetrit. Duhet ndalur më shumë në shpjegimin e motivit seksual, si motiv tejet kompleks, i cili ngërthen në vete motivet tjerë, por edhe vetitë tjera të personalitetit siç janë: temperamenti, karakteri, pikëpamjet, qëndrimet, paragjykimet etj. Tani është koha të jepen njohuri lidhur me sjelljen kulturore ndërmjet gjinive, posaqërisht të djemve ndaj vajzave, të prindërve ndaj fëmijëve etj. Nxënësit duhet të fitojnë njohuri lidhur me zhvillimin emocional dhe formimin e karakterit të fortë moral dhe formimit të shprehive kulturore dhe higjienike në përgjithësi dhe me veçori gjinishë në veçanti.

Praktika është burimi, por edhe fillimi i çdo njohurie dhe gjithnjë paraqitet si kriter i së vërtetës, sepse çdo njohuri e fituar verifikohet në praktikë. Në praktikë përmbajtjet teorike kuptohen më mirë. Veç kësaj, ajo edhe mundëson aftësimin e individit për jetë dhe punë. Prandaj, me të drejtë themi se çdo pjesë e përmbajtjes edukative dhe arsimore që duhet të përvetësohet nga nxënësit, është e lidhur me praktikën, e cila ua bën të mundshme që njohuritë mësimore-edukative të tyre të jenë më të qarta dhe më të kuptueshme. Edukimi në konvikte duhet të kuptohet si ndihmë që u jepet prindërve për edukimin e fëmijëve të tyre dhe jo si kompensim për edukimin familjar. Duhet theksuar se një klimë e përshtatshme, e cila do të përkujtonte klimën familjare, nuk varet vetëm nga format organizative dhe nga përmbajatjet e jetës në konvikt, por varet para se gjithash nga njerëzit, të cilët do të jenë në gjendje të shkaktojnë atmosferë të përshtatshme dhe sitsuata të volitshme, të ngajshme me ato në familje edhe pse as edhe vetë familja e natyrshme nuk është gjithmonë në gjendje që të krijojë klimë të përshtatshme!

Për një zhvillim sa më të gjithanshëm të personalitetit të nxënësit në konvikt është i nevojshëm mjedisi konviktor që ofron ngrohtësi, dashuri dhe siguri. Qoftë edhe konvikti më modern me gjithë kujdesin e tij pedagogjik, psikologjik, mjekësor e social, nuk mund të menjanojnë mungesat në zhvillimin social e emocional, në qoftë se nuk siguron një klimë të tillë edukimi, e cila përmbush nevojat e nxënësve.

**LITERATURA**


**Majkëll Fullan, Kuptimi i ri ndryshimeve në arsim, Tiranë,2001**
**Dr.Sci.Nijazi Zylfiu, Didaktika, Prishtinë,2004**
**Bardhyl Musai, Metodologji i mësimdhënies, Tiranë, 2003**
**Bardhyl Musai, Mjeshtritë themelore të mësimdhënies, Tiranë, 1996**
**Bardhyl Musai, etj., Studjoi gjithëçka, arsyes vendin e parë, Tiranë, 1998**
**Bardhyl Musai, Psikologji edukimi, Tiranë, 1999**
**Đorđe Lekić , Školska medijateka i sistem specijalizovanih učionica, Gornji Milanovac, 1897**
**Ernest Majer, Grupni oblici rada u nastavi, Zagreb, 1957**
**Hicela Jovan, Timska nastava , Rijekë, 1987**
**Mr. Hašim Muminovič, Individualizacija nastave i učenje matematike na tri nivoa učenika, Naša škola Sarajevë, 1984**
**Dr. Pero Shimlesha –Pedagogjia Zagreb 1978**
**Dr.Lubomir Kërneta,Dr.Nikola Potkosak,**
**Dr.Vlado Shmidt Dr.Pero Shimlesha- Pedagogjia II**
**I.Kovaqeviq – Programi i punës edukative - 1978**
**Marko Soldo, Bozhidar Staniq Planiranje i programiranje rada**
**Dr.Marko Furlan, Moderna nastava i intenzivno učenje, Zagreb, 1966**
**Dr.Marko Furlan, Učenje kao komunikacija, Zagreb, 1967**
**N.Mita, Metodat e mësimdhënjes, Tiranë, 1999**
**Musa Kraja, Pedagogjia, Tiranë, 1999**
**Dr.Maja Špan, Primjena programirane nastave u praksi, Zagreb, 1983**
**M.Stafanovič, Ž. Ilič, Rekreativna nastava,Beograd, 1980**
**Myra Polack, Mësuesit, Mësuesit, shkolla dhe shoqëria, Tiranë, 1999**
**Dr.Nijazi Zylfiu, Nevojat e ngritjes së kulturës pedagogjike të familjes si bazë për formimin e drejtë të personalitetit të fëmiut, Shkup,1968**
**Dr.Nijazi Zylfiu, Ambienti një prej faktorëve ndikues në realizimin e planit dhe programit mësimor në shkollat fillore, Prishtinë, 1966**
**Dr.Nijazi Zylfiu,Të mësuarit shikuar nga aspekti i komunikimit, Prishtinë,1976**
**Dr.Nijazi Zylfiu, Individualizimi në mësim, Prishtinë, 1976**
**Dr.Nijazi Zylfiu, Edukata seksuale e rinisë, Prishtinë, 1978**
**Dr.Nijazi Zylfiu, Značaj saradnje porodice i škole u planiranju slobodnog vremena učenika, Beograd, 1979**
**Dr.Nijazi Zylfiu, Zhvillimi i kreativitetit të nxënësve në mësim pjesë përbërëse e realizimit të detyrave edukative dhe arsimore,Prishtinë, 1995**
**Dr.Nijazi Zylfiu, Funksioni edukativ dhe arsimor i organizimit të kohës së lirë, Prishtinë,1986**
**Dr.Nijazi Zylfiu,Distraksioni i vëmendjes në mësim dhe evitimi i tij, Prishtinë, 2001**
**Dr.Nijazi Zylfiu,Struktura didaktike e organizimit të mësimit ekipor, Prishtinë,1988**
**Vlado Andrilovič,Programiranje učenje u nas i u svet, Zagreb,1980**